



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 27 regjistër (JR)
Datë 29.10.2018

Nr. 16 i vendimit
Datë 18.07.2019

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga:

Ina Rama	Kryesuese
Ardian Hajdari	Relator
Luan Daci	Anëtar
Sokol Çomo	Anëtar
Albana Shtylla	Anëtare

– mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 18.07.2019, ditën e enjte, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Branko Hrvatin, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Artan Broci, gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 53, datë 31.07.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës dhe nenet A, Ç, D, Dh, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”; Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Trupi gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e

Shqipërisë”, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes, analizoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisioni të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 53, datë 31.07.2018, ka vendosur:
 - *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Broci, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë.*
 - *Vendimi, i arsytuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.*
 - *Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), pasi ka filluar *ex officio* procesin e rivlerësimit, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, ka zhvilluar seancën dëgjimore publike dhe pasi ka marrë në shqyrtim të gjitha provat e administruara, si dhe shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimet e mëposhtme.

Sa i përket kriterit të rivlerësimit të pasurisë:

*i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të disa pasurive dhe të përmbushjes së detyrimeve financiare, siç është rasti për shtëpinë e plazhit, në {***}, Durrës dhe të ardhurat e krijuara nga shitja e saj [...].*

ii) Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime kontradiktore lidhur me pasurinë e tij [...].

iii) Gjatë hetimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, u konstatuan deklarime të pamjaftueshme dhe mungesë e burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë [...].

iv) Subjekti ka kryer deklaram të rremë lidhur me vlerën reale të blerjes së shtëpisë në plazh, Durrës.

v) Trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka pasuri të fshehtë të padeklaruar, e cila mbahet nga persona të tretë [...].

vi) Gjatë vlerësimit të pasurisë u konstatuan të paktën dy raste, për të cilat ai gjendet në situatën e konfliktit të interesit [...].

Sa i përket kriterit të rivlerësimit të figurës:

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta. Në përfundim, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës.

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit u bazua në (i) të dhënat e paraqitura në raportin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, dhe (ii) pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, relatori i çështjes propozoi për subjektin e rivlerësimit, z. A. Broci: “i aftë”.

Vlerësimi tërësor i çështjes:

Trupi gjykues i Komisionit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, denoncimet nga publiku, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, faktet e prezumuara nga ligji sipas nenit 49, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dhe pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, mbështetur në nenin 51 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në provat që disponon në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, konstaton se:

a) Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

*b) Në analizë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 46, datë 19.07.2016, të denoncimeve të ardhura nga publiku për subjektin e rivlerësimit, si dhe të mosmarrjes së veprimit ligjor, lidhur me deklarin e konfliktit të interesit, të paktën në një rast, në vendimin nr. {***}, datë 19.06.2014, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, gjykojmë se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.*

2. Kundër këtij vendimi me nr. 53, datë 31.07.2018, të Komisionit, brenda afatit ligjor, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit Artan Broci (në vijim “subjekti”), ankimi i të cilit ka rezultuar i plotë për shqyrtim, me elemente procedurale si të formës, edhe të përmbajtjes, për rrjedhojë, Komisioni me vendimin e tij nr. 5, datë 19.10.2018, ka vendosur pranimin e ankimit të datës 18.10.2018, me nr. 5575/12 prot., të paraqitur nga subjekti si ankim i plotë dhe në përputhje me parashikimet e nenit 46 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim “ligji nr. 49/2012”).

Subjekti në ankimin e tij ndaj vendimit nr. 53, datë 31.07.2018, të Komisionit ka paraqitur shkaqet si në vijim.

II. Shkaqet e ankimit

Shkaqet e ankimit të subjektit që lidhen me aspekte procedurale të çështjes dhe standardet e procesit të rregullt ligjor në Komision

3. Procesi i zhvilluar nga Komisioni, si dhe vendimi i dhënë në përfundim të tij, janë rezultat i një hetimi administrativ të njëanshëm, i realizuar në kundërshtim të plotë me normat procedurale dhe në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, si dhe në cenim të parimeve: (i) të arsytimit të vendimit; (ii) të eksedit; (iii) të kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve; (iv) të mosdiskriminimit; (v) të pavarësisë dhe paanësisë; (vi) të shtetit të së drejtës; (vii) të ligjshmërisë; (viii) parimi se ligji nuk ka fuqi prapavepruese (*zbatimi i ligjit në kohë dhe në hapësirë*).
4. Subjekti pretendon se i është mohuar e drejta për t’u njohur me aktet e administruara gjatë fazës së hetimit administrativ, nëpërmjet një vendimi absolutisht të pavlefshëm të relatores dhe jo të trupit gjykues së Komisionit.
5. Analiza e kryer nga Komisioni nuk është bërë mbi bazën e analizimit të të gjitha pasurive të deklaruara nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe, në funksion të verifikimit të saktësisë së të dhënave, Komisioni duhet të bënte krahasimin me deklaratat vjetore të pasurisë, por ai e ndërpreu në mënyrë të qëllimshme hetimin administrativ, duke mos kërkuar informacion shterues apo më keq, duke deformuar kërkimet për provat.

6. Pas dhënies së vendimit, subjekti është vënë në dijeni se dy anëtare të Komisionit, Valbona Sanxhaktari dhe Etleda Çiftja, kanë qenë në kushtet e konfliktit të interesit. Konkretisht, subjekti ankohet duke thënë në ankim se komisionerja Valbona Sanxhaktari nuk ka qenë e paanshme, pasi si ish-bashkëshortja e shtetasit A.R., i cili ka qenë i akuzuar si anëtar i dyshuar i organizatës kriminale “{***}”, për anëtarët e së cilës janë dhënë vendime edhe nga subjekti, është ndikuar në paanësinë e saj. Ndërsa për komisioneren Etleda Çiftja, subjekti pretendon konfliktin e interesit të saj për shkak të faktit se kjo komisionere ka blerë pasuri të paluajtshme nga shoqëria “{***}” dhe banon në të njëjtën hyrje pallati ku banon shtetasi A. B., ku ky i fundit është posedues i apartamentit për të cilin dyshohet subjekti se ka pasuri të padeklaruar. Kjo, sipas subjektit, ka bërë që procesi ndaj tij në Komision të jetë i parregullt ligjërisht, në shkelje themelore të të drejtave të tij, dualist dhe hakmarrje primitive për shkak të detyrës dhe qëndrimeve të tij gjatë dhe për shkak të detyrës.

7. Vendimi i Komisionit lidhur me analizën e pasurisë është rezultat i një gjykimi të njëanshëm, kontradiktor, duke u mbështetur vetëm në prova dhe gjetje që Komisioni ka mbledhur, pa shqyrtuar dhe analizuar provat dhe pretendimet e subjektit (*të paraqitura në funksion të barrës së provës të ngarkuar nga Komisioni*).

*Shkaku i ankimit në lidhje me pasurinë apartament me sipërfaqe 143 m² dhe vendndodhje në rrugën “{***}”, shk. {***}, ap. {***}, Tiranë*

8. Komisioni qëllimisht dhe në kundërshtim me ligjin nuk ka arsyetuar vendimin dhe ka nxjerrë një konkluzion të gabuar se: “Deklarimet e subjektit mbeten kontradiktore lidhur me sipërfaqen e ndërtimit të përmendur në kontratën e paraqitur si provë e re (46,3 m²) dhe sipërfaqen reale prej 65,7 m² të regjistruar të objektit shtesë anësore.”

*Shkaku i ankimit në lidhje me pasurinë apartament, me sipërfaqe 157,99 m² dhe vendndodhje në rrugën “{***}”, pall. {***}, hyrja {***}, ap. {***}, Tiranë*

9. Konkluzionet e hetimit të Komisionit në pikat 55 dhe 59 të vendimit, janë të gabuara në lidhje me mënyrën e pagesës së çmimit për apartamentin, kohën e kryerjes së saj dhe situatën e konfliktit të interesit në lidhje me shtetasin T. N.

*Shkaqet e ankimit në lidhje me pasurinë shtëpi në plazh, apartament me sipërfaqe 147 m² (papafingo) dhe vendndodhje në {***}, Durrës*

10. Lidhur me këtë pasuri, subjekti kundërshton konkluzionin që ka arritur Komisioni se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të disa pasurive dhe përmbushjes së detyrimeve financiare, siç është rasti për shtëpinë e plazhit, në {***}, Durrës dhe të ardhurat e krijuara nga shitja e saj, si dhe rastet e pasqyruara në pikat 105 dhe 111 të vendimit nr. 53, datë 31.07.2018, të Komisionit.

Subjekti pretendon se Komisioni ka gabuar në arritjen e konkluzionit për mungesë të burimit të ligjshëm për blerjen e pasurisë dhe ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara nga shitja e saj. Këto gabime kanë ardhur nga vlerësimi i gabuar i provave dhe nga hetimi i pamjaftueshëm.

Subjekti kundërshton konkluzionet e Komisionit për transaksionet e shitjes të z. F. Gj. , në mënyrë të veçantë realizimin e pagesës së çmimit nga F.Gj. tek Artan Broci. Kundërshtohet edhe konkluzioni i Komisionit se nga transaksioni ka ardhur si pasojë shmangia e pagimit të tatimit nga subjekti.

Subjekti pretendon se dyshimi për vlerën e lartë të transaksionit nuk është debatuar gjatë procesit në Komision.

Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit për deklarim të rremë në deklarimin në deklaratën *vetting* të çmimit të blerjes.

Subjekti pretendon standard të dyfishtë nga Komisioni, lidhur me qëndrimet dhe deklaratimet e pasakta të subjektit në deklaratën *vetting*.

Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit për konfliktin e interesit.

*Shkaku i ankimit në lidhje me pasurinë zyrë, me sipërfaqe 40 m² + 11,5 m² dhe me vendndodhje bulevardi “{***}”, Tiranë*

11. Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit se ka ngelur e paprovuar mënyra se si është kryer pagesa e çmimit të kësaj kontrate për kalimin e pronësisë së pasurisë zyrë, me sipërfaqe 40 m² + 11,5 m², më datë 28.02.2003, pasi rezulton se të gjitha tërheqjet nga banka janë kryer më datë 26.06.2003 dhe, për pasojë, subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për ta blerë këtë pronë në datën 28.02.2003, të deklaruar në kontratë.

Shkaku i ankimit në lidhje me të ardhurat e përfituara nga qiraja e shtëpisë në Shkodër

12. Subjekti ankohet duke u shprehur në ankim se: [...] Komisioni në vendimin nr. 53, datë 31.07.2018, ka ngritur pretendimin në pikën 217 të tij se nuk u provua ligjshmëria e të ardhurave të përfituara nga qiraja e shtëpisë në Shkodër, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Marrëdhënia e qirasë është deklaruar që në vitin 2004 e në vazhdim, si pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (në vijim “ILDKPKI”), ashtu dhe në deklaratën *vetting*. [...]

*Shkaku i ankimit në lidhje me investimin e kryer te dyqani me vendndodhje te “{***}”, Tiranë*

13. Subjekti kundërshton qëndrimin e Komisionit të mbajtur në paragrafin 224 të vendimit, lidhur me investimin në ambientin te “{***}”, për të cilin subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se përmirësimet e sendit janë kryer nga vetë qiramarrësit, duke paraqitur si provë edhe një deklaratë me nr. {***} prot., datë 2.07.2018, të lëshuar nga shoqëria “{***}” (qiramarrësi), e cila është administruar në dosje, duke pretenduar se këto investime nuk janë kryer prej tij, por prej qiramarrësit.

Shkaku i ankimit në lidhje me pasurinë e trajtuar nga Komisioni si pasuri e padeklaruar dhe e mbajtur nga persona të tjerë

14. Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit se ai ka mbajtur pasuri të padeklaruar, të fshehur, mbështetur në një hetim të njëanshëm, tendencioz, të pathelluar, pa i dhënë subjektit mundësi të shpjegohet përgjatë procesit të hetimit administrativ.

Shkaku i ankimit në lidhje me kontrollin e kriterit të figurës

15. Subjekti kundërshton një gjetje të Komisionit, sipas së cilës Artan Broci është propozuar në vitin 2004 nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për në Gjykatën e Krimeve të Rënda, por që nuk është dekretuar nga Presidenti i Republikës. Subjekti pretendon se është ndodhur para “efektit surprizë” edhe në këtë kriter, pasi kjo gjetje është jashtë afatit kushtetues dhe gjatë hetimit administrativ ai nuk është njohur për këtë gjetje të Komisionit.
Shkaqet e ankimit në lidhje me kontrollin e kriterit profesional

16. Vendimi i Komisionit është kontradiktor, në shkelje flagrante të ligjit dhe të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe përmban “efektin surprizë”, pasi nga njëra anë subjekti propozohet “i aftë” nga relatorja dhe më pas shkarkohet për shkak të “denoncimeve të ardhura nga publiku”, një vendimi të Gjykatës Kushtetuese me nr. 46, datë 19.07.2016, si dhe konfliktit të interesit të paktën në një rast.

Subjekti kundërshton administrimin nga Komisioni të dy raporteve shtesë nga Inspektorati i Këshilli të Lartë të Drejtësisë dhe të gjashtë ankesave me të cilat nuk rezulton që ai të jetë njohur gjatë procesit administrativ.

Arsyetimi i vendimit për subjektin është diskriminues dhe dualist në raport me subjektet e tjera të rivlerësimit, sa i përket trajtimit të rezultateve që dalin nga kontrolli i kriterit të aftësive profesionale.

Komisioni në mënyrë subjektive ka përzgjedhur tri denoncime, për të cilat ka marrë vlerësimin nga IKLD-ja dhe i ka bërë pjesë të arsyetimit të vendimit, megjithëse ato nuk përfshihen në burimet e vlerësimit profesional.

Subjekti kundërshton mënyrën se si Komisioni ka analizuar denoncimet e publikut dhe konkluzionet që ka arritur për këto denoncime.

17. Subjekti kundërshton qëndrimin e Komisionit në raport me analizën që i bëhet vendimit nr. 46, datë 19.07.2016, të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me situatën e konfliktit të interesit.

Kërkimet e subjektit në lidhje me provat e reja dhe parashtrirat e datës 29.03.2019 dhe të datës 08.07.2019, të depozituara në Kolegj

18. Së bashku me ankimin e tij, subjekti ka paraqitur një sërë provash të pretenduara të reja, duke kërkuar shqyrtimin e tyre nga Kolegji. Këto prova janë listuar si më poshtë.

a. Rreth 15 kontrata shitblerje pasurie të paluajtshme, së bashku me dokumentacionin bashkëngjitur. Këto kontrata janë lidhur midis z. F. Gj. si bashkëpronar dhe blerësve të ndryshëm. Këto dokumente janë paraqitur si prova të reja për të provuar që z. F. Gj. ka pasur mundësi financiare për të blerë apartamentin e banimit në plazh (***), Durrës).

b. Raport vlerësimi i pasurisë së paluajtshme (pa datë) apartament banimi, me sipërfaqe 103 m² dhe verandë 44 m², të ndodhur në Durrës. Ky raport është paraqitur për të provuar vlerën e tregut të apartamentit në Durrës.

c. Shkresë kthim përgjigjeje e datës 02.10.2018, nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të pasurive të Paluajtshme, drejtuar subjektit Artan Broci.

ç. Formular i deklaramentit dhe pagesës së tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat, datë 13.10.2018. Urdhër pagesë për tatimin e mbajtur në burim shtator 2018, paguar shuma 975.000 lekë, së bashku me formularin e urdhrit të transfertës.

d. Deklaratë noteriale e z. L. B., e datës 12.10.2018, i cili deklaron se i ka dhënë hua z. Artan Broci, shumen prej 24.000 USD për disa muaj dhe ky i fundit ia ka kthyer në qershor të vitit 2003.

dh. Kallëzim penal, i datës 08.10.2018, nga z. Artan Broci, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

e. Shkresë me nr. *** prot., datë 21.09.2018, e shoqërisë *** ShPK, drejtuar z. Artan Broci.

ë. Dokumente të nxjerra nga media e shkruar në lidhje me ish-bashkëshortin e komisioneres së Komisionit, znj. Valbona Sanxhaktari.

18.1. Më datë 29.03.2019, pranë Kolegjit, subjekti Artan Broci paraqiti parashtrimet shtesë lidhur më shkaqet e paraqitura ne ankim, bashkangjitur tyre edhe prova të reja dhe një CD audio-video. Këto parashtrime janë protokolluar pranë Kolegjit me nr. {***} prot., datë 29.03.2019.

18.2. Në bazë të kërkesës së tij të datës 20.11.2018, më datë 24.11.2018, subjekti është lejuar për t'u paraqitur pranë Kolegjit dhe për t'u njohur me dosjen e tij. Pas njohjes me aktet e dosjes dhe marrjes së kopjes së disa akteve të saj, sipas kërkesës së tij, subjekti ka depozituar pranë Kolegjit një material me parashtrime mbi ankimin dhe prova të reja që janë renditur si më poshtë.

a. Vendimi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 18.10.2018, “Për regjistrimin e procedimit penal për përdorimin e të dhënave personale”.

b. Shkresë kthim përgjigjeje për z. Artan Broci nga kompania {***} i, më datë 09.11.2018, bashkëngjitur një listë e banorëve të ndërtesës nr. {***}, hyrja {***}, Rruga e {***}, Tiranë.

c. Deklaratë noteriale e z. E. P., administratorit të ndërtesës nr. {***}, ndodhur në Rrugën e {***}.

ç. Shkresë kthim përgjigjeje për z. Artan Broci nga kompania {***}.

d. Shkresë nr. {***} prot., datë 19.06.2018, e OShEE-së, drejtuar Komisionit.

dh. Shkresë nr. {***} prot., datë 06.02.2018, e OShEE-së, drejtuar Komisionit.

e. Shkresë nr. {***} prot., datë 17.04.2018, e OShEE-së, drejtuar Komisionit.

ë. Vendim nr. {***}, datë 02.04.2015, i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi, së bashku me analizën e sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

f. Vendim nr. {***} regj., datë 10.12.2009, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

g. *E-mail* dërguar z. A. M., datë 15.02.2010.

gj. Relacion i Këshilltares Ligjore E. M.

h. Vendim nr. {***}, datë 16.07.2013, i Gjykatës së Lartë.

i. Materiali i faqes zyrtare elektronike të Gjykatës së Lartë për çështjen e V. Ç. (data e regjistrimit 21.07.2016), pasi dosja ka ardhur nga Gjykata Kushtetuese dhe është caktuar relator, gjyqtari M.B.

j. Materiali i faqes zyrtare elektronike të Gjykatës së Lartë për çështjen e V. Ç. (data e regjistrimit 22.04.2015), ku është caktuar relator, gjyqtari Artan Broci. Data e gjykimit – 16.07.2015, në dhomë këshillimi, vendimmarrja – mospranim rekursi.

k. Ligji nr. 33/2017 “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore”.

l. Zarf me CD audio-video, regjistrimi me lejen e punonjësës së Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Tiranë.

ll. Mandatpagesë për marrjen e akteve të fotokopjuara nga Komisioni.

18.3. Së fundmi, subjekti, më datë 08.07.2019, pasi është njohur me njoftimin nr. 806/41 prot., datë 27.06.2019, të Kolegjit “Për zhvillimin e seancës në dhomë këshillimi”, si dhe me

shpalljen publike nr. 27/2 prot., datë 27.06.2019, “Për gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi”, ka paraqitur brenda afatit ligjor para Kolegjit shpjegime shtesë, si dhe prova të tjera të reja, konkretisht një vendim pushimi të çështjes penale nga prokurori i çështjes, të datës 13.06.2019, dhe një printim të një faqeje nga *flash draiver*-i i subjektit.

Në shpjegimet shtesë, subjekti shprehet dhe kërkon si më poshtë.

Së pari, konfirmimin se i qëndron plotësisht ankimit të tij dhe parashtrimeve mbi ankimin e depozituar pranë Kolegjit, më datë 29.03.2019, si dhe provave të reja të depozituara në funksion të tij.

Së dyti, subjekti bën me dije se është njoftuar nga organi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë (shkresa me nr. {***} prot., datë 19.06.2019) për kërkesën për pushimin e çështjes penale nr. {***} që u përket akteve të procedimit penal nr. {***}/2018 mbi bazën e kallëzimit të kryer prej subjektit Artan Broci, më datë 08.10.2018 (çështja është në fazë gjykimi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, seksioni penal).

Së treti, subjekti në këtë parashtrësë trajton denoncimin nr. 7, për të cilin Komisioni shprehet në faqen 35 të vendimit nr. 53, datë 31.07.2018, denoncim në lidhje me një çështje civile në Gjykatën e Apelit Tiranë. Nga aktet e përcjella për vlerësim, shprehet Komisioni, rezulton se kohëzgjatja e gjykimit në Gjykatën e Apelit Tiranë ka qenë 9 muaj e 24 ditë, tej afatit 6-mujor të parashikuar. Subjekti në këtë parashtrësë, mbas gjetjeve të *flash driver*-it të vendimeve që ka hartuar si gjyqtar i Gjykatës së Apelit, konsultimit me të, në kompjuter, më datë 25 prill 2019, i rezulton se vendimi Apelit, {***}-{***} që u korrespondon palëve e që bën fjalë për vendimin nr. {***}, datë 17.05.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë, ku subjekti ka qenë relator, është prodhuar prej tij më datë 23.05.2011, pra vetëm 6 ditë mbas shpalljes së vendimit.

Në përfundim të kësaj parashtrëse, ashtu si në ankim, edhe në parashtrësat e datës 29.03.2019, të depozituara në Kolegj, subjekti ka kërkuar:

Kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, për efekt se gjykimi në shkallë të parë në Komision, ka shkelje të standardeve të procesit të rregullt ligjor, se gjykimi ka qenë formalist dhe subjekti ka të drejtë të dëgjohet të paktën në një shkallë gjykimi, ku t’i garantohet e drejta substanciale për t’u dëgjuar, pasi çështja është jo vetëm çështje ligji, por edhe e faktit dhe e provave. Riçeljen dhe përsëritjen e hetimit gjyqësor e administrimin e provave të reja të paraqitura nga subjekti, mbi bazën e parimit të kontradiktoritetit.

III. Vlerësimi i rrethanave të çështjes dhe analiza e shkaqeve të ankimit nga trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Vlerësimi i aspekteve procedurale të çështjes

19. Juridiksioni i rivlerësimit dhe kompetencat e Kolegjit të Posaçëm të Apelit përcaktohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 179/b të saj, ku ndër të tjera, në pikën 5 të këtij neni, parashikohet: *Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese*, si dhe në nenin 5, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave: *1. Procesi i vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë. 2. Kolegji i Apelit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Komisionit dhe ka mandat 9-vjeçar. Gjithashtu kompetencat e Kolegjit të Posaçëm të Apelit përcaktohen në mënyrë specifike edhe në nenin F të Aneksit të Kushtetutës: 1. Kolegji i Apelit përbëhet nga shtatë gjyqtarë dhe është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet kundër vendimeve të Komisionit [...] 2. Ndaj vendimeve të Komisionit mund të ushtrojnë ankim pranë këtij Kolegji subjekti i rivlerësimit dhe*

Komisioneri Publik, sipas ligjit, me përjashtim të vendimeve të marra sipas nenit E, paragrafi 2, të Aneksit. 3. Kolegji mund të kërkojë mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigjojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit, duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të rivlerësuar. Kolegji vendos në lidhje me çështjen dhe nuk mund t'ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim. Juridiksioni kushtetues nuk lejon të vihen në diskutim parimet e kushtetutshmërisë, mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit dhe si i tillë bazohet tek kriteret e përcaktuara në këtë ligj [...] 7. Kolegji lë në fuqi, ndryshon ose rrëzon vendimin e Komisionit, duke dhënë vendim me shkrim të arsyetuar. [...]

20. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) zhvillohet bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48/1, 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012.

Shqyrtimi i ankimit të subjektit u zhvillua në dhomë këshillimi në bazë dokumentesh, në përputhje me nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 49/2012.

21. Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “trupi gjykues”), në lidhje me çështjen konkrete për gjykim, fillimisht konstatoi se subjekti i rivlerësimit Artan Broci legjitimohet për të ushtruar ankim në Kolegji, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe në kuptim të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pasi ankimi është depozituar brenda afatit ligjor – vendimi i është komunikuar subjektit më datë 04.10.2018, ankimi është bërë më datë 18.10.2018. Ankimi kundër vendimit nr. 53, datë 31.07.2018 të Komisionit, rezulton të jetë i plotë edhe në elementet e tjera, si të formës, ashtu edhe të përmbajtjes. Konstatohet gjithashtu se njoftimet për vendimin e Komisionit dhe për ankimin janë bërë nga Komisioni në përputhje me nenet 63 dhe 64 të ligjit nr. 84/2016 dhe në Kolegji njoftimet për gjykimin në dhomë këshillimi janë bërë rregullisht, në përputhje me nenin 49 të ligjit nr. 49/2012.
22. Trupi gjykues, në lidhje me provat e reja të renditura më lart, si ato bashkëngjitur ankimit, edhe ato bashkëngjitur parashtrimeve të datës 29.03.2019 dhe të datës, 08.07.2019, në përputhje me nenin 49, pika 9 e ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenet 47 dhe 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 dhe në nenin 49, pika 6, germat “a”, “b” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016, vendosi refuzimin e marrjes së tyre si provë për shqyrtim, duke argumentuar dhe arsyetuar si më poshtë.

Së pari, në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara. Nga verifikimet e procedurave të Komisionit, ka rezultuar se sipas procesverbalit të seancës dëgjimore në Komision të datës 27.07.2018, të orës 13:00, subjekti i rivlerësimit Artan Broci, i paraqitur personalisht, ka konfirmuar se i ka marrë në dorëzim të gjitha materialet e dosjes si në formatin elektronik, edhe në letër, është njohur më parashtrimet e relatores së trupit gjykues në Komision dhe rezultatet e hetimit kryesisht, është dëgjuar duke dhënë parashtrimet e tij dhe duke paraqitur provat në formën e kërkuar nga ligji, kopje të njësuar me origjinalin ose origjinale, të cilat janë administruar nga Komisioni. Rezulton gjithashtu se shpjegimet dhe provat e subjektit janë marrë në konsideratë nga Komisioni dhe atij nuk i është refuzuar marrja e asnjë prove. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues me vendim të ndërmjetëm vendosi refuzimin e marrjes së provave të renditura në paragrafët më sipër, nr.18/a/b dhe nr.18.2./ë/f/g/gj/l.

Së dyti, sipas parashikimeve të nenit 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, ku përcaktohet shprehimisht se: [...] *Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes*

parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim, kuptohet se ankuesi mund të paraqesë në apel vetëm parashtrime në lidhje me shkaqet e ankimit dhe jo fakte ose shkaqe ankimi të reja apo prova bashkëngjitur tyre, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në neni 47 i ligjit nr. 49/2012.

Së treti, në tërësinë e tyre, provat e renditura në paragrafët më sipër, 18/c/ç/d/dh/e/ë dhe 18.2./a/b/c/ç/ll, duken se janë të panevojshme për thelbin e çështjes dhe, për pasojë, të parëndësishme për vendimmarrjen. Për më tepër, nga pikëpamja procedurale vlerësohen si të panevojshme dhe për shqyrtimin e vendimit nr. 53, datë 31.07.2018, të Komisionit. Ndërsa provat e tjera të renditura në paragrafët më sipër 18.2./d/dh/e, ndodhen në dosjen e administruar nga Komisioni dhe rezulton se nuk janë të reja dhe është i panevojshëm dublimi i tyre. Ndërsa pjesa tjetër e tyre, ose synojnë të provojnë fakte në favor të subjektit, të cilat edhe po të konsiderohen të vërteta, nuk ndikojnë në marrjen e vendimit, ose nuk janë relevante për thelbin e çështjes që shqyrtohet në Kolegj.

Për më tepër, trupi gjykues, në përputhje me kërkesat e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, kryesisht çmon se debati gjyqësor në seancë gjyqësore, me praninë e palëve, është i panevojshëm pasi: a) vlerësohet se konstatimi i gjendjes faktike është bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e prova të reja; b) nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje, apo gjendje faktike të konstatuara gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni; c) nuk vlerësohet se është nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të marra në Komision.

Vlerësimi i trupit gjykues lidhur me pretendimet dhe kërkimet e subjektit të rivlerësimit në ankim

A. Vlerësimi i trupit gjykues lidhur me pretendimin dhe kërkimin në ankim të subjektit për shkelje të standardeve të procesit të rregullt ligjor në Komision dhe kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në Kolegj

23. Në ankim, siç janë cituar, por jo vetëm, në paragrafët më sipër, nr. 3, 4, 7, 10, 14, 15, dhe 16 të këtij vendimi, subjekti pretendon se në Komision ka pasur shkelje procedurale dhe se janë cenuar dhe shkelur një sërë parimesh të procesit të rregullt ligjor.

Trupi gjykues i Kolegjit, duke çmuar se parimet e procesit të rregullt ligjor janë të detyrueshme të zbatohen dhe garantohen nga cilido organ shtetëror që zhvillon një proces administrativ, përfshirë institucionet e rivlerësimit për vetë juridiksionin e tyre, sipas kërkesave të ligjit nr. 84/2016, në analizimin e shkaqeve të ankimit të subjektit për këtë pretendim, vlerëson se:

23.1. Nga shqyrtimi i procedurave të çështjes së subjektit Artan Broci, konstatohet se Komisioni në tërësinë e hetimit administrativ i ka zbatuar parimet e procesit të rregullt ligjor. Konkretisht, rezulton se: vendimi është i arsyetuar; subjektit i është garantuar e drejta e aksesit në aktet e dosjes së tij përpara seancës dëgjimore, duke iu garantuar mundësia e përgatitjes së mbrojtjes; i është dhënë mundësia dhe i është garantuar e drejta e paraqitjes së provave dhe shpjegimeve; anëtarët e komisionit janë treguar të pavarur dhe të paanshëm në detyrën tyre; rezulton se është garantuar edhe parimi i ligjshmërisë, parimi se ligji nuk ka fuqi prapavepruese; nuk rezulton i vërtetuar një interpretim ligjor i gabuar, me qëllim rëndues për subjektin, apo të jetë cenuar parimi i sigurisë juridike dhe i barazisë para ligjit për subjektin, apo i shtetit të së drejtës. Gjithashtu, nuk rezultojnë të vërtetuara pretendimet e subjektit për një mënyrë gjykimi subjektive, të njëanshme, qëllimisht rënduese dhe diskriminuese të Komisionit apo rrjedhojat e një interpretimi dhe zbatimi të gabuar të dispozitave specifike, si edhe pretendimi se vendimi

është i mbështetur vetëm në provat që ka mbledhur Komisioni, pa shqyrtuar dhe analizuar provat dhe pretendimet e tij.

23.2. Në lidhje me pretendimin në ankim të subjektit mbi parregullsitë dhe paligjshmërinë e vendimit datë 04.04.2018, të marrë nga relatorja Valbona Sanxhaktari, nga shqyrtimi i procedurave, trupi gjykues konstatoi se edhe pse subjekti nuk është njohur me aktet në kohën dhe mënyrën sipas kërkesës së tij, Komisioni në përfundim të hetimit paraprak, përpara seancës dëgjimore, e ka njohur subjektin me aktet e dosjes, duke i dhënë edhe kohën e mjaftueshme për t'u përgatitur për mbrojtjen e tij.

Trupi gjykues, në analizimin e këtij shkakut ankimi konstaton se, në një komunikimin elektronik që ka pasur Komisioni me subjektin, rezultoi se në përgjigje të kërkesës së subjektit, relatorja i kthen përgjigje duke i thënë se pas shqyrtimit të kërkesës, Komisioni e refuzoi atë me arsyetimin se e drejta e njohjes dhe e vënies në dispozicion të provave të grumbulluara gjatë hetimit administrativ nuk mund të ushtrohet gjatë procedurës së hetimit administrativ, por në përfundim të saj. Nga procesverbali i datës 17.04.2018, mbajtur në Komision, rezultoi se refuzimi i kërkesës së subjektit për t'u njohur me dokumentet e dosjes se tij, është marrë vetëm nga relatorja Valbona Sanxhaktari, pa miratimin e anëtarëve e tjerë të trupit gjykues në Komision. Në vlerësimin e trupit gjykues, edhe pse ky akt i datës 04.04.2018 rezultoi i parregullt në kuptimin formal, nuk është vendim i ndërmjetëm, por gjithashtu nuk është as akt absolutisht i pavlefshëm, siç pretendon subjekti në ankim dhe, për pasojë, nuk afekton edhe vendimin përfundimtar të çështjes objekt shqyrtimi. Kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë dëgjimore në Komision dhe vendimi përfundimtar objekt shqyrtimi është firmosur dhe miratuar nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues në Komision.

23.3. Në vijim të analizimit të shkakut të ankimit të cituar në paragrafin 4, nga shqyrtimi i akteve, rezultoi se Komisioni me vendimin nr. 02, datë 19.06.2018, e ka njoftuar subjektin për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative. Më datë 22.06.2018 rezultoi se subjekti ka pasur akses në dosje dhe ka marrë kopje të akteve të saj. Më datë 03.07.2018, rezultoi se subjekti, pasi është njohur me aktet e dosjes, ka paraqitur provat e tij dhe ka kërkuar më shumë se njëzet ditë kohë për të realizuar mbrojtjen. Me vendimin nr. 4, datë 09.07.2018, Komisioni ka vendosur të zgjatë afatin e parashikuar 20-ditor për subjektin e rivlerësimit, me 7 ditë shtesë. Gjithashtu, rezultoi se në Komision, më datë 17.07.2018, subjekti ka dërguar prova të reja, të cilat Komisioni i ka marrë dhe i ka vlerësuar, duke ia ka nënshtruar analizës së tij. Seanca dëgjimore në Komision, pas njoftimit dhe marrjes dijeni rregullisht nga subjekti, është zhvilluar në prani të subjektit më datë 27.07.2018, në orën 13:00. Në seancë dëgjimore, subjekti ka dhënë parashtrimet e tij dhe ka paraqitur provat në formën e kërkuar nga ligji, kopje të njësuara me origjinalin ose origjinale dhe në përfundim ka kërkuar konfirmim në detyrë.

Në lidhje me shkakun e ankimit të trajtuar në paragrafin 7 të këtij vendimi, trupi gjykues çmon se ndryshe nga sa ka pretenduar subjekti në ankim, se Komisioni e ka mbështetur vendimin e tij vetëm në provat e mbledhura nga Komisioni, rezultoi se edhe provat e paraqitura nga subjekti janë marrë në shqyrtim. Ky fakt pasqyrohet në paragrafët nr. 34, nr. 55, nr. 104, nr. 136, nr. 258 dhe nr. 279 të vendimit objekt shqyrtimi të Komisionit.

23.4. Në lidhje me pretendimin në ankim të subjektit se edhe në hetimin e analizimin e pasurive ka qenë i paragjykuar dhe ndaj tij ka pasur një sjellje diskriminuese e dualiste në Komision, duke përmendur në ankim një vendim pakice, në të cilin vetë relatorja e çështjes Valbona Sanxhaktari dhe komisionerja tjetër Etleda Çiftja japin një koncept tjetër në lidhje me të njëjtat raste (mendim pakice, vendimi nr. 51, datë 18.07.2018, i Komisionit; vendimi nr. 24, datë

13.06.2018, i Komisionit, vendimi nr. 26, datë 21.06.2018, i Komisionit, vendimi nr. 13, datë 05.04.2018, i Komisionit dhe vendimi nr. 54, datë 31.07.2018), trupi gjykues çmon të vlerësojë se analizimi i qëndrimeve nga i njëjti trup gjykues në Komision, për subjekte të ndryshme, në mënyra të ndryshme, duhet të analizohet dhe argumentohet në mënyrë të paanshme dhe mbi bazën e të njëjtave parime dhe jurisprudencës së Kolegjit. Duke u kthyer te rasti në gjykim, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka qenë i paragjykuar në Komision dhe nuk rezulton të provohet një sjellje diskriminuese apo dualiste në Komision në dëm të të drejtave themelore të subjektit.

23.5. Në lidhje me pretendimin e subjektit se nuk është gjykuar nga një gjykatë e paanshme, trupi gjykues, nga shqyrtimi i vendimit objekt gjykimi dhe i procedurave për marrjen e tij, nuk konstatoi njëanshmëri të Komisionit në vendimarrjen e tij përfundimtare.

23.6. Në lidhje me pretendimin në ankim se vendimi i Komisionit është kontradiktor, në shkelje flagrante të ligjit dhe të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe përmban “efektin surprizë”, pasi nga njëra anë subjekti propozohet “I aftë” nga relatorja dhe më pas shkarkohet nga detyra, trupi gjykues vlerëson se nuk jemi para rastit të një procesi të parregullt ligjor, pasi si denoncimet e ardhura nga publiku, si vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 46, datë 19.07.2016, ashtu edhe situatën e konfliktit të interesit, Komisioni, përveçse i ka shqyrtuar dhe debatuar në seancë dëgjimore, i ka vlerësuar drejt, sipas kërkesave të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe jo në kuadrin e vlerësimit të aftësive profesionale, siç pretendon gabimisht subjekti.

Sa më sipër, pretendimi në ankim i subjektit të rivlerësimit për shkelje të standardeve të procesit të rregullt ligjor në Komision dhe kërkimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në Kolegj nuk gjenden të bazuar në prova e në ligj.

B. Vlerësimi i trupit gjykues lidhur me ndërprerjen në mënyrë të qëllimshme të hetimit administrativ

- 24.** Në lidhje me pretendimin e subjektit për ndërprerjen në mënyrë të qëllimshme nga Komisioni të hetimit administrativ, të trajtuar në paragrafin 5 të këtij vendimi, pretendohet se analiza e kryer nga Komisioni nuk është bërë mbi bazën e analizimit të të gjitha pasurive të deklaruara nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe, në funksion të kësaj procedure, për të konfirmuar saktësinë e të dhënave në deklaratën e pasurisë *vetting*, Komisioni duhet të bënte krahasimin me deklaratat vjetore të pasurisë dhe jo të ndërpriste në mënyrë të qëllimshme hetimin administrativ, duke mos kërkuar informacion shterues apo, më keq, duke deformuar kërkimet për provat.

Trupi gjykues vlerëson në lidhje me shkakun “B” më sipër se ligji nr. 84/2016, në nenin 32, pika 5 parashikon se deklaratat e pasurisë të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga organet e rivlerësimit. Këto deklarata, së bashku me provat e tjera, vlerësohen në tërësi me rrethanat e çështjes, për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë për verifikimin dhe vlerësimin e deklaratës së pasurisë *vetting*. Objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit në deklaratën e rivlerësimit krahasuar me deklaratimet periodike, ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të (pasuri e paluajtshme/e luajtshme/likuiditete). Në vijim të analizës dhe interpretimit të dispozitave të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka në diskrecionin e tij, referuar kërkesave të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, fillimin dhe përfundimin e procedurave hetimore për subjektet e rivlerësimit. Me të drejtë Komisioni, bazuar në nenin 51

të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur bazuar në provat që janë disponuar dhe faktet e vërtetuara gjatë hetimit administrativ, në funksion edhe të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

C. Vlerësimi i trupit gjykues lidhur me konfliktin e interesit të anëtarëve të Komisionit

25. Në lidhje me shkakun e ankimit të trajtuar në paragrafin 6 të këtij vendimi, për pretendimin e konfliktit të interesit të anëtarëve të Komisionit për të cilat subjekti shprehet se pas dhënies së vendimit është vënë në dijeni se dy anëtarë të Komisionit, Valbona Sanxhaktari dhe Etleda Çiftja, kanë qenë në kushtet e konfliktit të interesit. Konkretisht, subjekti ankohet duke thënë në ankim se komisionerja Valbona Sanxhaktari nuk ka qenë e paanshme, pasi si ish-bashkëshortja e shtetasit A.R., i cili ka qenë i akuzuar si anëtar i dyshuar i organizatës kriminale “{***}”, për anëtarët e së cilës janë dhënë vendime edhe nga subjekti, është ndikuar në paanësinë e saj. Ndërsa për komisioneren Etleda Çiftja, subjekti pretendon konfliktin e interesit të saj për shkak të faktit se kjo komisionere ka blerë pasuri të paluajtshme nga shoqëria “{***}” dhe banon në të njëjtën hyrje pallati ku banon shtetasi A. B., ku ky i fundit është posedues i apartamentit për të cilin dyshohet se subjekti e ka pasuri të padeklaruar. Kjo, sipas subjektit, ka bërë që procesi ndaj tij në Komision të jetë i parregullt ligjërisht, në shkelje themelore të të drejtave të tij, dualist dhe hakmarrje primitive për shkak të detyrës dhe qëndrimeve të tij gjatë dhe për shkak të detyrës.

Në vijim të analizës, trupi gjykues për pretendimin e subjektit për konflikt interesi të komisioneres Valbona Sanxhaktari dhe fakteve që ai paraqet për këtë pretendim, çmon se analiza për këtë pretendim duhet të kryhet mbështetur në dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative, të cilave neni 27 i ligjit nr. 84/2016 u referohet në mënyrë të posaçme, dhe në nenin 72 e vijues të Kodit të Procedurës Civile. Kjo e fundit është një normë që rregullon posaçërisht kushtet e përjashtimit të një gjyqtari nga një proces gjyqësor, ndërkohë që neni 27 i ligjit nr. 84/2016 parashikon nenin 30 të Kodit të Procedurës Administrative si bazë ligjore referuese për të rregulluar situatën e konfliktit të interesit për anëtarët e institucioneve të rivlerësimit, veçanërisht anëtarët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në analizë të dispozitave ligjore që rregullojnë konfliktin e interesit dhe konkretisht të nenit 30 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative” (në vijim “ligji nr. 44/2015”), gërmat “a”, “b” dhe “g” të kësaj dispozite përcaktojnë se një nëpunës publik (në rastin konkret, komisionerja relatore) kërkohet të mos përfshihet në një procedurë administrative kur bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërm të tij deri në shkallë të dytë kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim. Nga sa konstatohet nga aktet e administruara në dosje gjatë hetimit administrativ, por edhe nisur nga sa parashtrohet vetë në ankim subjekti i rivlerësimit, si dhe duke pranuar si të vërteta faktet e paraqitura prej tij, rezulton se shtetasi A. R. nuk ka qenë bashkëshorti i komisioneres relatore në kohën e zhvillimit të procedurës administrative, kohë në të cilën ai ka pasur statusin e ish-bashkëshortit, për shkak të zgjidhjes së martesës shumë kohë më parë. Duke qenë në statusin e ish-bashkëshortit, referuar përcaktimeve të nenit 30, germa “b” e ligjit nr. 44/2015 të sipërcituar, i cili parashikon se bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim, ai nuk rezulton të jetë i përfshirë në rrethin e personave që mund të vendosin në kushtet e konfliktit të interesit komisioneren relatore të trupit gjykues të Komisionit. Në të njëjtën situatë paraqitet rasti edhe në këndvështrim të parashikimeve që bën ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9367/2005”) për rrethin e personave të lidhur me zyrtarin, i cili mund të gjendet në kushtet e konfliktit të interesit. Neni 3, pika 11 dhe neni 5 i ligjit nr. 9367/2005 nuk parashikojnë ish-bashkëshortin si një person që mund të konsiderohet person i lidhur me zyrtarin, element që

përrjashton analizën e mëtejshme për ekzistencën e kushteve që parashikon ky ligj për situatën e konfliktit të interesit dhe pasojave e të mënyrës për zgjidhjen apo shmangien e këtij konflikti. Ndërsa për komisioneren tjetër, Etleda Çiftja, subjekti nuk paraqet asnjë fakt apo rrethanë që parashikohet në nenin 27 të ligjit nr. 84/2016, për të bërë një analizë të mëtejshme për ekzistencën e kushteve që parashikon ligji për situatën e konfliktit të interesit.

Përfundimisht, në analizë të situatës faktike dhe ligjore të përshkruar më lart, trupi gjykues çmon që pretendimi se komisioneret Valbona Sanxhaktari dhe Etleda Çiftja janë gjendur në kushtet e konfliktit të interesit në vendimmarrjen për subjektin, është i pabazuar në ligj dhe, si i tillë, nuk duhet të përkrahet në shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Ç. Vlerësimi i trupit gjykues lidhur me kërkimin e subjektit për t'u dëgjuar në Kolegj

26. Gjithashtu i pabazuar gjendet edhe kërkimi i subjektit për t'u dëgjuar në Kolegj, pasi rezulton se kjo e drejtë i është garantuar nga Komisioni në seancën dëgjimore dhe subjekti ka ushtruar të drejtën e paraqitjes së provave dhe shpjegimeve në Komision. Për më tepër, në përputhje me pikën 1, të nenit 49, të ligjit nr. 49/2012, gjykimi në apel si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh, në dhomë këshillimi. Për sa më sipër, trupi gjykues nuk e çmoi të nevojshëm kalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë publike për t'i dhënë mundësi subjektit për t'u dëgjuar edhe në Kolegj. Kjo edhe për faktin se kërkimi/argumenti që paraqet subjekti për kalimin e çështjes në seancë publike nuk parashikohet në rastet specifike, sipas kërkesave të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012.

D. Denoncime nga publiku për subjektin, të ardhura në Kolegj

27. Në Kolegj, para dhe pas shpalljes së vendimit të Komisionit dhe pas ardhjes së dosjes nga Komisioni në Kolegj, janë depozituar denoncimet si më poshtë.

27.1. Më datë 07.12.2018, në Kolegj ka ardhur denoncimi i protokolluar me nr. {***} prot., i bërë nga z. Sh. R. B.

27.2. Më datë 05.03.2019, në Kolegj ka ardhur denoncimi i protokolluar me nr. {***} prot., i bërë nga z. S. M.

27.3. Më datë 06.06.2018, në Kolegj ka ardhur denoncimi i z. H. R., denoncim i cili është paraqitur edhe para Komisionit.

27.4. Më datë 28.1.2019, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit ka ardhur denoncimi i protokolluar me nr. {***} prot., i bërë nga znj. R. M.

27.5. Më datë 16.05.2019, në Kolegj ka ardhur denoncimi i protokolluar me nr. {***} prot., i bërë nga znj. V. Z.

27.6. Më datë 25.05.2019, në Kolegj ka ardhur denoncimi i protokolluar me nr. {***} prot., i bërë nga z. H. R.

27.7. Më datë 31.05.2019, në Kolegj ka ardhur denoncimi i protokolluar me nr. {***} prot., i {***}.

27.8. Më datë 31.05.2019, në Kolegj është përcjellë nga Komisioni denoncimi i protokolluar me nr. {***} prot., i bërë nga z. S. T.

27.9. Më datë 27.06.2019, në Kolegj ka ardhur denoncimi i protokolluar me nr. {***} prot., i bërë nga znj. H. K.

Trupi gjykues, pasi i vlerësoi një e nga një denoncimet e mësipërme, çmoi se nga rrethanat dhe informacionet që kanë parashtruar denoncuesit e cituar më sipër, bazuar në kërkesat e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, ato nuk përmbajnë fakte dhe prova që krijojnë bindje për shkelje ligjore dhe nuk përmbajnë shkaqe të mjaftueshme për fillimin e hetimit kryesisht në Kolegj. Si të tilla, në rastin konkret, këto denoncime nuk iu nënshtruan hetimit të mëtejshëm.

28. Për të gjithë sa më sipër, trupit gjykues lidhur me pretendimin dhe kërkimin në ankim të subjektit për shkelje të standardeve të procesit të rregullt ligjor në Komision dhe kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në Kolegj; ndërprerjen në mënyrë të qëllimshme të hetimit administrativ në Komision; konfliktin e interesit të anëtareve të Komisionit; kërkimin e subjektit për t'u dëgjuar në Kolegj; denoncimet e ardhura rishtas në Kolegj; me vendim të ndërmjetëm, sipas parashikimeve të nenit 49, pika 6, geramat "a", "b" dhe "d" të ligjit nr. 84/2016, si dhe të neneve 47 dhe 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, në dhomë këshillimi, vendosi:
1. Të refuzojë marrjen për shqyrtim të provave të reja të paraqitura nga subjekti bashkë me ankimin dhe me parashtruesat e tij përgjatë gjithë kohës që çështja qëndronte për studim në Kolegj.
 2. Të mos hetojë më tej në lidhje me 9 (nëntë) denoncimet e reja të paraqitura në Kolegj, për shkak se konstaton që nuk gjendet para të dhënave apo kritereve që parashikon neni 53 i ligjit nr. 84/2016 për legjitimitimin e një hetimi të mëtejshëm.
 3. Në zbatim të nenit 49 dhe nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, të zhvillojë shqyrtimin e kësaj çështjeje në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi.

Analizimi nga trupi gjykues i shkakut të ankimit në lidhje me pasurinë apartament, me sipërfaqe 143 m² dhe vendndodhje në rrugën "{*}"**

29. Në lidhje me shkakun e ankimit të trajtuar në paragrafin 8 të këtij vendimi, në të cilin subjekti pretendon se Komisioni qëllimisht dhe në kundërshtim me ligjin nuk arsyeton vendimin dhe nxjerr një konkluzion të gabuar se: *Deklarimet e subjektit mbeten kontradiktore lidhur me sipërfaqen e ndërtimit të përmendur në kontratën e paraqitur si provë e re (46,3 m²) dhe sipërfaqen reale prej 65,7 m² të objektit, të regjistruar shitesë anësore*, trupi gjykues vlerëson se ky shkak ankimi qëndron, pasi konkluzioni i Komisionit është i gabuar. Por edhe pse qëndron ky shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se nuk e bën të cenueshëm vendimin e Komisionit. Në analizë të këtij shkakut ankimi, rezulton e provuar e kundërta e konkluzionit të Komisionit, pasi si në deklaratën periodike, edhe në atë *vetting* subjekti ka bërë të njëjtin deklaram për sipërfaqen. Për më tepër, Komisioni duhej të kishte parasysh arsyetimin se, meqenëse deklaramet periodike të pasurisë mund të merren si provë nga Komisioni dhe Kolegji, të gjitha duhet t'i nënshtrohen kontrollit, verifikimit, krahasimit me deklaratën *vetting*, por edhe me njëra-tjetrën në deklaramet e pakësimeve dhe shitesave nëse përputhen edhe me dokumentacionin e bashkëlidhur, duke i shërbyer procesit në tërësi me kontrollin e pasurive, ligjshmërinë e burimit, si dhe përmbushjen e detyrimeve financiare. Nga kjo rrjedh arsyetimi se nuk mund të mos jenë objekt kontrolli edhe veçmas deklaramet periodike për të arritur në konkluzionet nëse janë të sakta dhe të vërteta deklaramet e subjekteve të rivlerësimit, pasi saktësia dhe mjaftueshmëria janë tregues të cilët dalin nga krahasimi jo vetëm i provave dhe dokumenteve me deklaratën *vetting*, por edhe nga krahasimi i deklarametave periodike në vite me deklaratën *vetting*.

29.1. Vlerësimi i trupit gjykues në lidhje me argumentet që paraqet subjekti në këtë shkak ankimi për pasurinë apartament me sipërfaqe 143 m² dhe vendndodhje në rrugën "{***}" është se, në respektim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, si dhe në zbatim të parimit të barazisë para ligjit, analizimi i mospërputhjeve në sipërfaqe ndërtimi nga i njëjti trup gjykues, për subjekte të ndryshme në mënyra të ndryshme, duhet të analizohet dhe argumentohet në mënyrë

të paanshme dhe mbi bazën e të njëjtave parime dhe standarde. Neni 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 përcakton detyrimin që kanë institucionet e rivlerësimit që të ushtrojnë funksionet e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Sa më sipër, ky shkak ankimi është i arsyeshëm, por nuk e bën të cenueshëm vendimin. Bazuar në dispozitat kushtetuese, ligjin nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se, nëpërmjet ankimit evidentohen zbatimi i parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe problematikat e vendimmarrjes në Komision, dhe Kolegji ka të drejtë të korrigjojë çdo gabim procedural të kryer nga Komisioni e të përcaktojë sa kanë ndikuar këto gabime te vendimi. Kolegji, si organi i vetëm gjyqësor në procesin e rivlerësimit, në funksion të shqyrtimit të vendimit nëpërmjet ankimit, zgjidh çështjen në mënyrë përfundimtare.

E kundërta e asaj që pretendon subjekti do të ishte problem, pra nëse një standard të mbajtur më parë nga Kolegji, nëpërmjet një arsyetimi të një vendimi ku ka korrigjuar shkeljet procedurale dhe orientuar Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme, Komisioni nuk e ka zbatuar, atëherë kjo do të mund të përbënte shkak për cenimin e vendimit të Komisionit.

Analizimi nga trupi gjykues i shkaqeve të ankimit në lidhje me pasurinë apartament 157,99 m², me adresë rruga “{*}”, pall. {***}, hyrja {***}, ap. {***}, Tiranë**

30. Në lidhje me shkakun e ankimit të trajtuar në paragrafin 9 të këtij vendimi, në të cilin subjekti kundërshton konkluzionet e hetimit të Komisionit në pikat 55 dhe 59 të vendimit, konkluzione që sipas tij janë të gabuara në lidhje me mënyrën e pagesës së çmimit për apartamentin, kohën e kryerjes së saj dhe situatën e konfliktit të interesit në lidhje me shtetasin T. N.

30.1. Vlerësimi i trupit gjykues në lidhje me këtë shkak ankimi është se, në respektim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, si dhe në zbatim të parimit të barazisë para ligjit, analizimi i mospërputhjeve në deklarime me aktet mbështetëse të tyre, duhet të kryhet dhe argumentohet në mënyrë të paanshme dhe mbi bazën e të njëjtave parime. Duke pasur parasysh interpretimin ligjor se kontrata është akt autentik ligjor, për sa i përket vullnetit, qëllimit dhe mënyrës së lidhjes së saj, sepse ka fuqinë e ligjit për palët që e kanë nënshkruar atë dhe kjo sipas kërkesave të nenit 690 të Kodit Civil, nga verifikimi i këtij shkak ankimi konstatohet se me të drejtë Komisionit i kanë rezultuar mospërputhje mes fakteve dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit. Subjekti nuk ka justifikuar nëpërmjet lëvizjeve bankare pagesën e këtij apartamenti deri më datë 07.07.2011, në shumën prej 6.851.600 lekësh, pasi rezulton se ai ka tërhequr vetëm 4.000.000 lekë nga BKT-ja deri në datën e lidhjes së kontratës. Duhet të theksohet fakti se në kontratën e shitblerjes nr. {***}, rep., dhe nr. {***}/ {***} kol., datë 07.07.2011, lidhur mes subjektit në cilësinë e blerësit dhe familjes N. në cilësinë e shitësit, flitet vetëm për sipërfaqen e shtëpisë ekzistuese dhe jo se çmimi do të përfshinte edhe shtesën që i dhurohet subjektit më pas me kontratën e dhurimit nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 23.12.2014. Në vazhdim të analizës, bazuar në pretendimin e subjektit për të provuar me deklaratat e dëshmitarëve ndryshimin e kushteve të kontratës, trupi gjykues, duke iu referuar nenit 232 të Kodit të Procedurës Civile ku parashikohet: *Nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar ose privat që përbën provë të plotë. Gjithashtu nuk lejohet të provohet me dëshmitarë marrëveshja e palëve për ndryshimin e kontratës [...] – vlerëson se sipas këtij përcaktimi pretendimi i subjektit dhe dëshmia e shtetasve N. dhe D. për të kundërshtuar kushtet e kontratës nuk lejohet të merret si provë, pasi kontrata përbën një akt juridik me fuqi të plotë provuese, e cila rezulton e lidhur rregullisht nga palët në prani të noterit publik, me vullnetin e tyre të plotë, duke u dakordësuar dhe nënshkruar. Për më tepër, në përputhje me nenin 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet: Komisioni dhe Kolegji i*

Apelimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes – me të drejtë Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka reflektuar vlerën, kohën dhe mënyrat e pagesës së kësaj prone në asnjë prej deklaratave vjetore të pasurisë dhe në deklaratën e pasurisë vetting dhe, për pasojë, subjekti nuk i mbështet pretendimet e tij në prova të besueshme dhe pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera.

30.2. Ndryshe nga sa pretendon subjekti në ankim, për trupin gjykues, të arsyeshme dhe të drejta gjenden konstatimet e Komisionit në lidhje me konfliktin e interesit të subjektit me gjykimin nga ana e tij të çështjes civile, ku ka qenë anëtar i Kolegjit Civil dhe vendimmarrës në vendimin nr. {***}, me nr. {***} regjistri themeltar, me datë 22.05.2014, me paditës L.Q, palë e paditur AKKP dhe me person të tretë Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (në vijim “ZVRPP”) në Berat dhe T. N. Në lidhje me këtë situatë juridike, Kolegji në vendimin nr. 9 (JR), datë 24.10.2018, ka mbajtur qëndrimin: *Lidhur me parimin e paanësisë, “Rezoluta me 10 parimet bazë”, e miratuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, shprehet: “Gjyqtarët duhet që të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të paanshme duke e garantuar dhe evidentuar paanshmërinë. Ata duhet të kujdesen që të shmangin në çdo rast konfliktin e interesit, por edhe përzierjen në të gjitha ato situata të cilat perceptohet se e përfshijnë apo krijojnë për gjyqtarët konflikt interesi. Lidhur me paanshmërinë, gjyqtarët duhet të ushtrojnë funksionet e tyre me paanshmëri të plotë, si dhe të garantojnë dukjen e paanshmërisë”.* Në vendimin e Kolegjit nr. 10/2019¹, është mbajtur i njëjti standard në lidhje me konfliktin e interesit të gjyqtarit. Pretendimi i subjektit se çështja e mësipërme ka qenë konflikt kompetencash dhe nuk ka qenë çështje themeli që duhej të jepte dorëheqjen, nuk gjendet i bazuar në ligj, pasi nuk përjashtohet ligjërisht asnjë çështje, qoftë kjo e konfliktit të kompetencave që të justifikojë qenien e gjyqtarit në vendimmarrjen e këtyre çështjeve gjyqësore, duke u ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit. Kjo situatë faktike e pohuar edhe nga vetë subjekti në lidhje me vendimmarrjen e subjektit në vendimin e Gjykatës së Lartë nr. {***}, me nr. {***} regjistri themeltar, më datë 22.05.2014, me palë ndërgjyqëse: paditës L.Q., palë e paditur AKKP dhe person i tretë Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat dhe T. N., në raport me kërkesat e nenit 5 të ligjit nr. 9367/2005, e vë subjektin në kushtet dhe situatën e konfliktit të interesit, pasi subjekti nuk duhej të merrte pjesë në vendimmarrjen përkatëse, ku palë ndërgjyqëse ishte një shtetas me të cilin ka pasur apo vazhdon të ketë marrëdhënie preferenciale, juridiko-civile, apo angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e nenit 5 të ligjit nr. 9367/2005.

Analizimi nga trupi gjykues i shkaqeve të ankimit në lidhje me pasurinë shtëpi plazh, apartament 147,99 m² (papafingo), në Durrës

31. Në lidhje me këtë pronë dhe shkakun e ankimit të trajtuar në paragrafin 10 të këtij vendimi, subjekti kundërshton konkluzionin që ka arritur Komisioni se ai nuk ka mundur të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të disa pasurive dhe përmbushjes së detyrimeve financiare, siç është rasti për shtëpinë e plazhit, në {***}, Durrës dhe të ardhurat e krijuara nga shitja e saj, si dhe rastet e pasqyruara në pikat 105 dhe 111 të vendimit nr. 53, datë 31.07.2018.

¹ [...] Për pasojë, në përputhje me nenin 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ishte në konflikt interesi në gjykimin e çështjes nr. {***}, në Gjykatën e Lartë. Për më tepër, siç ka vendosur Kolegji i Posaçëm i Apelit, lidhur me paanshmërinë, “gjyqtarët duhet të ushtrojnë funksionet e tyre me paanshmëri të plotë, si dhe të garantojnë dukjen e paanshmërisë” (qëndrim i mbajtur në vendimin nr. 9, datë 24.10.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit).

Subjekti pretendon se Komisioni ka gabuar në arritjen e konkluzionit për mungesë të burimit të ligjshëm për blerjen e pasurisë dhe ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara nga shitja e saj. Këto gabime kanë ardhur nga vlerësimi i gabuar i provave dhe nga hetimi i pamjaftueshëm.

Subjekti kundërshton konkluzionet e Komisionit për transaksionet e shitjes të z. F. Gj., në mënyrë të veçantë realizimin e pagesës së çmimit nga F. Gj. tek Artan Broci. Kundërshtohet edhe konkluzioni i Komisionit se nga transaksioni ka ardhur si pasojë shmangia e pagimit të tatimit nga subjekti.

Subjekti pretendon se dyshimi për vlerën e lartë të transaksionit nuk është debatuar gjatë procesit në Komision.

Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit për deklarim të rremë të çmimit të blerjes në deklaratën e pasurisë *vetting*.

Subjekti pretendon standard të dyfishtë nga Komisioni për konkluzionin e tij në lidhje me qëndrimet dhe deklaratimet e pasakta në deklaratën e pasurisë *vetting*.

Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit për konfliktin e interesit.

31.1. Trupi gjykues konstaton se Komisioni ka arritur në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të disa pasurive dhe përmbushjes së detyrimeve financiare, në rastin për shtëpinë e plazhit, në {***}, Durrës dhe të ardhurat e krijuara nga shitja e saj, si dhe në rastet e pasqyruara në pikat 105 dhe 111 të vendimit nr. 53, datë 31.07.2018 të tij.

Për arsye të lidhjes mes pasurive, pasi pasuria në plazh ka shërbyer si burim të ardhurash dhe shtim pasurie, nga Komisioni, hetimi administrativ u shtri në procedurat e kryera për blerjen dhe më pas shitjen e saj nëpërmjet kontratës së prenotimit/porosisë nga subjekti.

Rezulton se këtë pronë subjekti e ka porositur më datë 06.09.2006, sipas kontratës së prenotimit/porosisë të lidhur mes shoqërinë ndërtuese “{***}” ShPK, para noteres B. Ç., me çmim 55.140 euro. Sipas nenit 2 të kësaj kontrate, çmimi do paguhej me 3 këste. Në ditën e lidhjes së kontratës, porositësi/subjekti ka paguar në zyrën e noterisë shumë prej 20.000 eurosh. Kësti i dytë prej 15.000 euro do të paguhej brenda datës 20.02.2007 dhe kësti i tretë dhe i fundit prej 20.140 eurosh do të paguhej më datë 20.09.2007. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, si burim të krijimit të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar pjesërisht kursimet dhe pjesërisht kredinë në Bankën Amerikane, sot Intesa San Paolo Bank. Subjekti ka deklaruar se ia ka shitur këtë apartament në vlerën prej 102.000 eurosh, shtetasit F. Gj, duke paraqitur një kontratë për prenotim dhe dorëzim apartamenti të datës 15.04.2010. Në këtë kontratë të fundit thuhet se shuma prej 82.000 eurosh është paguar jashtë zyrës noteriale dhe shuma prej 20.000 eurosh do të paguhet deri në datën 20.12.2010. Subjekti ka deklaruar se shuma prej 82.000 eurosh është investuar në bono thesari në Bankën e Shqipërisë, duke paraqitur një faturë të datës 12.05.2010 për konvertimin e shumës 80.000 euro në lekë tek agjencia valutore “I{***}” ShPK, si dhe një dokument të po kësaj date për transferimin e shumës prej 10.000.000 lekësh pranë Bankës së Shqipërisë për bono thesari.

Komisioni, në lidhje me shitblerjen e këtij apartamenti ka ngritur dyshime dhe, për këtë fakt, ndër të tjera, i është drejtuar shoqërisë “{***}” ShPK, e cila nga ana e saj sqaron se apartamenti i është shitur z. Broci me kontratën e porosisë datë 06.09.2006, në vlerën prej 55.140 eurosh dhe shoqëria i ka bërë një zbritje nga çmimi total prej 5.140 eurosh pa ndonjë arsye.

Në deklaratën periodike të vitit 2006, subjekti ka deklaruar çmimin siç është në kontratë në shumën prej 55.140 eurosh dhe në deklaratën e pasurisë *vetting* ka deklaruar çmimin 55.000 euro. Për këtë fakt është pyetur subjekti, i cili në komunikimin elektronik që ka pasur me Komisionin është përgjigjur: *Vlera e apartamentit është ajo e deklaruar në kontratë, pra 55.140 euro, por kur kam paguar këstin e fundit më është bërë një zbritje nga njëri prej ortakëve, afërsisht 10% e shumës totale të apartamentit dhe vlera reale që kam paguar për këtë apartament është 50.000 euro.*

Rezultoni e provuar se, siç u tha më lart se më datë 15.04.2010 subjekti ka lidhur një kontratë noteriale prenotimi dhe dorëzimi apartamenti me shtetasin F. Gj., të cilit i shet këtë apartament kundrejt çmimit prej 102.000 eurosh.

Nga hetimi administrativ në Komision, ka rezultuar se për këtë apartament ka dy kontrata porosie/prenotimi me të njëjtën datë, 15.04.2010, me porositës shtetasin F. Gj.: një mes këtij të fundit dhe shoqërisë “{***}” ShPK në cilësinë e të porositurit dhe një tjetër mes po këtij porositësi, shtetasit F. Gj., dhe z. Artan Broci në cilësinë po të të porositurit.

Nga kontrata e shitjes nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 02.12.2016, lidhur mes palës shitëse “{***}” ShPK dhe palës blerëse F. Gj., në përmbajtje të saj rezultoni se sipas certifikatës së pronësisë nr. {***}, të lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Durrës, më datë 09.12.2015, kjo pasuri, shtëpi plazhi, apartament 147,99 m², ka rezultuar në pronësi të shoqërisë “{***}” ShPK dhe jo të subjektit të rivlerësimit.

Në dëshminë e tij në Komision, z. F. Gj. ka deklaruar se shtëpinë e ka blerë nga z. Broci dhe se lekët ia ka dhënë atij, jo shoqërisë “{***}” ShPK dhe se ka qenë subjekt deklarimi i pasurisë dhe e ka deklaruar këtë pasuri. Nga ana tjetër, subjekti ka paraqitur pranë Komisionit librezat e ujit dhe të energjisë elektrike për të provuar se ndryshimi i emrit nga z. Broci te z. F. Gj. është bërë bazuar në kontratën e lidhur midis tij dhe z. F. Gj.. Subjekti pretendon se nuk është njoftuar asnjëherë nga shoqëria “{***}” ShPK për të nënshkruar kontratën e shitjes dhe nuk ka marrë asnjë kujtesë noteriale nga shtetasi F. Gj. për hipotekimin e apartamentit dhe përmbushjen e detyrimeve të tij, sipas kontratës së prenotim/dorëzimit të apartamentit, datë 15.04.2010.

Rezultati i hetimit të Komisionit për këtë fakt është: *Sipas analizës ekonomike, rezultoi se subjekti nuk ka pasur burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme në vitin 2006, për të paguar këstin e parë të prenotimit të banesës.* (Komisioni nuk ka marrë si burim të ligjshëm të gjitha të ardhurat e pretenduara nga subjekti nga qirratë e dyqanit të “{***}” dhe të zyrës të “{***}”).

Trupi gjykues i Komisionit nuk u bind nga sqarimet e subjektit për pagesën e vlerës së këtij apartamenti ndaj z. Broci, kësti i parë dhe i dytë.

Subjekti ka kryer deklarim të rremë lidhur me vlerën reale me të cilën ai ka blerë apartamentin të shoqëria “{***}” ShPK (nuk ka deklaruar vlerën reale të blerjes, 50.000 euro).

Komisioni konstatoi gjendjen e konfliktit të interesit në vendimmarrjen e subjektit të vendimi i Gjykatës së Lartë nr. {***}, datë 19.06.2014, ku palë e paditur ka qenë shoqëria “{***}” ShPK.

Trupi gjykues, pasi bëri vlerësimin e të gjithë dokumentacionit përkatës në raport me këtë shkak ankimi dhe me konkluzionet e Komisionit në lidhje me situatën dhe mundësinë financiare të subjektit për të blerë pasurinë në plazh, Durrës, vlerëson se, nga analiza financiare e realizuar në Kolegj, bazuar në pretendimet e subjektit, duke konsideruar si të ardhura të ligjshme të gjitha të ardhurat nga qiradhënia të deklaruara nga subjekti në deklaratat e interesave privatë periodikë/vjetorë, duke konsideruar kursimet e deklaruara nga subjekti në

gjendje *cash* në banesë vit pas viti dhe duke zbritur vlerën e pasurisë shtëpi plazh, apartament 147,99 m², sa i përket këstit të parë në shumën prej 20.000 eurosh, përsëri rezulton se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për të përbëlluar krijimin e kësaj pasurie, pagesën e shpenzimeve familjare dhe gjithashtu krijimin e kursimeve në formën e likuiditeteve *cash* në banesë. Pra, gjendja financiare e subjektit mbetet negative edhe nëse merren si të ardhura të ligjshme qiratë, për të cilat nuk provohet pagimi i tatimit. Kjo analizë financiare, mbështetur në pretendimet e subjektit, shpjegohet se, për të pasur një situatë të qartë financiare të vitit 2006, duhet të kryen përlllogaritjet financiare duke i konsideruar si të ligjshme të gjitha të ardhurat e deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike. Për të përlllogaritur nëse subjekti ka pasur kursime *cash* në banesë nga vitet e mëparshme, duhet të bazohemi në deklaratimet periodike të subjektit, për të cilat specifikohet: *në deklaratën e parë të vitit 2003*, subjekti ka deklaruar: “[...] lekë shqiptarë në *cash* – 500.000 lekë [...], me burim kursime nga të ardhurat e qirasë dhe të familjes, si dhe të bashkëshortes [...]”; *në deklaratën periodike të vitit 2004*, subjekti ka deklaruar “[...] 700.000 + 500.000, me burim nga kursimet e vjetshme, 1.200.000 lekë kursime në bashkëpronësi me bashkëshorten, data dhe viti i krijimit të pasurisë: viti 2003 e 2004”; *në deklaratën periodike të vitit 2005*, subjekti nuk ka deklaruar as shtim dhe as pakësim të gjendjes *cash*.

Nga sa më sipër, vitin 2006 subjekti e fillon me gjendje *cash* në banesë, në vlerën 1.200.000 lekë. Gjendja e llogarive bankare të subjektit në fillim të këtij viti është 135.841,55 lekë. Në vitin 2006 të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes së tij nga puna dhe aktiviteti noterial janë në shumën 2.728.981 lekë, të ardhurat nga qiradhënia e njësisë të biznesit dyqan pranë zonës së “{***}” janë në shumën 1.080.000 lekë (1.200.000 të ardhura në total, minus 120.000 lekë tatim fitimi, 10%), të ardhurat e deklaruara nga qiradhënia e njësisë së biznesit pranë bulevardit “{***}” janë 303.497,28 (deklaruar në shumën 3.600 USD, të cilat të konvertuara në lekë me kursin historik të Bankës të Shqipërisë (Lekë/USD 93,672) janë 337.219,2. Kësaj shume i zbrësim vlerën 33.721,92 lekë si tatim fitimi (10%). Të ardhurat nga qiradhënia e shtëpisë në qytetin e Shkodrës janë deklaruar në vlerën 333.998,1 lekë (në deklaratën periodike është deklaruar vlera 3.000 euro, e konvertuar me kursin historik të Bankës së Shqipërisë (Lekë/Euro 123,703) rezulton 371.109 lekë. Kësaj vlere i zbrësim tatim fitimin në vlerën 37.110,9 lekë). Totali i të ardhurave të mësipërme është në vlerën 4.446.476,38 lekë. Totali i shpenzimeve të kryera nga subjekti për këtë periudhë është në vlerën 1.490.573,91 lekë. Pagesa e këstit të apartamentit për këtë vit është në vlerën 2.477.000 lekë. Në fund të këtij viti, në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë të vitit 2006, subjekti ka deklaruar kursime *cash* në vlerën 1.700.000 lekë. Gjendja e llogarive bankare në fund të vitit është në vlerën 344.246,4 lekë. Totali i të ardhurave është 4.446.476,38 lekë, të cilit në këtë rast do t’i shtojmë vlerën e kursimeve të viteve më parë, në vlerën 1.335.841,55 lekë dhe do t’i zbrësim shpenzimet 1.490.573,9 lekë, minus vlerën e apartamentit 2.477.000 lekë, minus kursimet e krijuara në fund të vitit në banesë në vlerën 2.044.246,4 lekë. Në situatën më të mirë për subjektin, do të rezultonte përfundimisht balanca negative prej 229.502,36 lekësh.

Ligjshmëria e të ardhurave nga qiraja, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, në Komision për vitin 2006 është llogaritur vetëm për dyqanin te “{***}”, në vlerën 900.000 lekë, pa llogaritur gabimisht vlerën prej 180.000 lekësh, si e ardhur nga qiraja për këtë pasuri që rezulton e provuar sipas shkresës nr. {***} prot., datë 05.07.2018, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë dhe mandatit të arkëtimit nr. {***}, datë 22.04.2005. Gjithsesi, në vlerësim të trupit gjykues, edhe pse vlera e saktë e të ardhurave nga qiraja për vitin 2006 nga dyqani te “{***}” duhej të ishte 1.080.000 lekë, balanca negative nuk ndryshon. Në konkluzion të sa më sipër, nga analiza ekonomike dhe ligjore e kryer në Kolegj, duke i marrë si të ligjshme, sipas pretendimeve dhe deklaratimeve të subjektit, edhe pse nuk provohen me dokumentacion, të gjitha të ardhurat nga qiraja për njësitë tregtare, dyqan te “{***}” dhe

zyrë te bulevardi “{***}”, si dhe për shtëpinë në Shkodër, në pronësi të subjektit të rivlerësimit, përsëri subjekti rezulton me një diferencë negative për vitin 2006, në vlerën 229.502,36 lekë. Nëse në analizën e mësipërme, nuk do të përfshiheshin të ardhurat nga qiratë për të dyja njësitë tregtare në pronësi të subjektit dhe nga shtëpia në Shkodër, të cilat nuk vërtetohen me akte zyrtare nga organet tatimore, situata financiare e tij nuk do të përmirësohej, por do të rezultonte me një diferencë negative në vlerën 866.997,7 lekë.

Lidhur me sa më sipër, referuar situatës financiare të subjektit për vitin 2006, rezulton se ai nuk arrin të justifikojë me të ardhura të ligjshme blerjen e pasurisë, sa i përket këstit të parë prej 20.000 eurosh, si edhe shpenzimet dhe kursimet e krijuara në këtë vit. Në këto kushte, situata faktike klasifikohet sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

Prandaj pretendimi i subjektit në ankim, se Komisioni ka gabuar në vlerësimin e provave në atë masë sa të cenohet vendimi objekt shqyrtimi nuk qëndron, ashtu siç nuk qëndron edhe pretendimi tjetër i subjektit në ankim se hetimi në Komision ka qenë i pamjaftueshëm në lidhje me shtëpinë në plazh, Durrës.

31.2. Në vijim të analizës së shkaqeve të ankimit në lidhje me pasurinë shtëpi në plazh, Durrës, sa i përket kundërshtimit të subjektit për transaksionet e shitjes të z. F. Gj. dhe konkluzioneve të Komisionit për këtë transaksion dhe për konsiderimin e z. F. Gj. në cilësinë e “personit tjetër të lidhur”, trupi gjykues konstaton se, nga shqyrtimi i dokumentacionit që ndodhet në dosje, Komisioni në asnjë paragraf të vendimit të tij, me të drejtë nuk e ka cilësuar shtetasin F. Gj. si person të lidhur, apo person tjetër të lidhur. Nuk rezulton ndonjë deformim i provave apo dëshmive të marra nga Komisioni për këtë fakt, siç pretendon subjekti në disfavor të tij. Shpjegimet dhe pretendimet e subjektit për të provuar burimin e ligjshëm të kësaj pasurie dhe të të ardhurave nga kjo pasuri, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, nuk ishin të mjaftueshme për të bërë të cenueshëm vendimin e Komisionit. Trupi gjykues në vlerësimin e këtij shkakut ankimi, në raport me vendimin e Komisionit, nuk konstaton kontradiktë mes analizave të paragrafëve 140 dhe 141 të vendimit. Konkluzionet e Komisionit në paragrafin 141 të vendimit të tij, ku shprehet ndër të tjera se subjekti nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë dhe të të ardhurave nga shitja e apartamentit dhe, me veprimet e mosveprimeve të tij, ka arritur të shmangë pagimin e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë, u gjetën të drejta dhe të mbështetura në parashikimet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

31.3. Në vijim të analizës në lidhje me pasurinë shtëpi në plazh, Durrës, sa i përket pretendimit të vlerës së lartë të transaksionit, edhe pse kjo vlerë nuk është debatuar në Komision, subjekti në ankim nuk shpjegon bindshëm se si pothuajse u dyfishua, në harkun kohor prej katër vitesh, vlera e pasurisë në Durrës, nga 55.140 euro në vitin 2006 në 102.000 euro në vitin 2010. Trupi gjykues konstaton se Komisioni në paragrafin 122 të vendimit të tij shprehet drejt se, duke iu referuar çmimit të lartë të shitjes së këtij apartamenti, miqësisë së vjetër të z. Broci me z. Gj. (të deklaruar nga palët) dhe veprimeve fiktive të kryera për këtë pasuri mes shoqërisë “{***} ShPK dhe z. G., trupi gjykues nuk u bind për pagesën e vlerës së apartamentit ndaj z. Broci, për këstin e parë dhe të dytë. Raportimet nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave konfirmojnë lidhjen e kontratës noteriale mes z. Broci dhe z. Gj., por nuk paraqesin ndonjë fakt apo provë lidhur me pagimin e shumës. Po ashtu, këto raportime flasin për transaksione bankare për derdhjen e lekëve *cash* në llogari nga shtetasi Artan Broci, si dhe blerjen e bonove të thesarit nga ai, por nuk paraqesin ndonjë fakt apo provë lidhur me mënyrën e qarkullimit të parave nga blerësi të shitësi. Sa më sipër, nuk qëndron pretendimi i ngritur nga subjekti, pasi Komisioni nuk i ka ngritur dyshimet për çmimin e shitjes në nivelin e masës

disiplinore për subjektin, por i ka vlerësuar këto dyshime për çmimin dhe mënyrën e pagimit të kësteve nga blerësi te shitësi, në raport me dështimin e subjektit për të provuar mënyrën e pagimit të çmimit mes palëve në këtë marrëdhënie.

Nga ana tjetër, duket se në paragrafin 116 të arsyetimit të vendimit, Komisioni i ka kushtuar rëndësinë e duhur provës së marrë, nga e cila rezulton se firma “{***}” ShPK në muajin prill 2010 ka qenë me xhiro zero lekë, por kjo nuk e bind trupin gjykues që kjo shumë është paguar në favor të subjektit dhe jo të kësaj shoqërie. Komisioni nuk rezulton se ka shkelur parimin e objektivitetit, pasi janë analizuar kontratat e subjektit sipas raportimeve që ka bërë Drejtorja e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave. Në paragrafin 123 të vendimit të tij thuhet: *Raportimet nga Drejtorja e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave konfirmojnë lidhur me kontratën noteriale mes z. Broci dhe z. Gj., por nuk paraqesin ndonjë fakt apo provë lidhur me pagimin e shumës. Po ashtu, ato flasin për transaksione bankare për derdhjen e lekëve cash në llogari nga shtetasi Artan Broci, si dhe blerjen e bonove të thesarit nga ai, por nuk paraqesin ndonjë fakt apo provë lidhur me mënyrën e qarkullimit të parave nga blerësi te shitësi.*

Në përfundim, nga trupi gjykues u vlerësua se nuk provohet pagimi i çmimit të shitjes subjektit në shumën 102.000 euro në vitin 2010.

31.4. Në lidhje me kundërshtimin nga subjekti të konstatimit të Komisionit për deklarim të rremë të vlerës së blerjes së pasurisë në Durrës, trupi gjykues, duke e vlerësuar të drejtë arsyetimin e Komisionit në paragrafin 105 të vendimit të tij, konstaton se si në deklaratën *vetting*, edhe në atë periodike, subjekti për këtë pasuri ka bërë deklarim të rremë lidhur me vlerën reale të blerjes së kësaj pasurie. Rezultoni se subjekti edhe pse se ka qenë në dijeni të plotë të së vërtetës, nuk ka pasqyruar faktin e vërtetë në deklarin e tij në deklaratën *vetting*, në lidhje me vlerën e blerjes së apartamentit në Durrës. Në këto kushte, situata faktike klasifikohet sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.

Subjekti në mënyrë persistente në ankimin e tij ka ngritur pretendimin për standarde të dyfishta dhe ka kërkuar që Kolegji të ndjekë qëndrimet që janë mbajtur për subjekte të tjera të rivlerësimit nga Komisioni për të njëjtat fakte. Qëndrimet e mbajtura në vendimet e tjera për subjekte të tjera të rivlerësimit nga Komisioni, nuk janë detyruese dhe nuk kushtëzojnë vlerësimet e Kolegjit në çështjet që gjykon, siç pretendon subjekti në këtë shkak ankimi.

31.5. Në lidhje me kundërshtimet dhe pretendimet e subjektit ndaj konkluzioneve të Komisionit për konfliktin e interesit të subjektit kur ka gjykuar në vitin 2014, e konkretisht më datë 19.06.2014, një mosmarrëveshje civile gjyqësore, që shoqëria “{***}” ShPK ka pasur me shtetasit V. Ll. etj., nga analizimi i këtij shkak ankimi, trupi gjykues e gjen të drejtë përfundimin e Komisionit për pronën apartament 147,99 m², me vendndodhje në Durrës, ku është shprehur se duke vlerësuar që konflikti i interesit është gjendja e konfliktit mes detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, i cili duhet të kryejë në mënyrë të drejtë dhe me përgjegjësi detyrat, nisur nga rrethanat e çështjes dhe problematikat e hasura në lidhje me pasurinë në fjalë, të shpjeguar në pikat 60-130 të vendimit të Komisionit, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte dhënë dorëheqjen nga gjykimi i çështjes gjyqësore ku palë ndërgjyqëse ka qenë shoqëria “{***}” ShPK, duke u vetëpërgjashtuar paraprakisht nga procesi konkret vendimmarrës e duke mos marrë pjesë në diskutimin dhe votimin e çështjes. Trupi gjykues, duke pasur parasysh faktet, si: kontratën e vitit 2006 mes subjektit si blerës dhe shoqërisë “{***}” ShPK si shitëse; zbritjen e çmimit prej 5.140 eurosh nga shoqëria “{***}” ShPK në favor të subjektit; kontratën mes subjektit si shitës tashmë i kësaj prone dhe z. F. Gj. si blerës; vendimmarrjen në çështjen gjyqësore civile në Gjykatën e Lartë nga subjekti në vitin 2014; kontratën e vitit 2016 ku z. F. Gj. shfaqet si blerës përsëri për së dyti dhe këtë radhë nga

shoqëria “{***}” ShPK; marrëdhëniet e pohuara të miqësisë së subjektit me ortakët e shoqërisë “{***}” ShPK, u bind për ekzistencën e konfliktit të interesit. Në lidhje me këto situata juridike të ngjashme, Kolegji në vendimin nr. 9 (JR), datë 24.10.2018, të tij, ka mbajtur qëndrimin: *Lidhur me parimin e paanësisë, “Rezoluta me 10 parimet bazë”, e miratuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, shprehet: “Gjyqtarët duhet që të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të paanshme, duke e garantuar dhe evidentuar paanshmërinë. Ata duhet të kujdesen që të shmangin në çdo rast konfliktin e interesit, por edhe përzierjen në të gjitha ato situata të cilat perceptohen se e përfshijnë apo krijojnë për gjyqtarët konflikt interesi. Lidhur me paanshmërinë, gjyqtarët duhet të ushtrojnë funksionet e tyre me paanshmëri të plotë, si dhe të garantojnë dukjen e paanshmërisë”.* Komisioni për të qenë sa më i qartë duhej t’u referohej këtyre parimeve të GjEDNj-së dhe bazës ligjore në legjislacionin tonë të brendshëm, konkretisht ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (në vijim “ligji nr. 9367”), nenit 5, pika 1, gerrat “b”, “c”, “dh”, “v” dhe “e” të tij, për të përforcuar konkluzionet mbi gjendjet faktike dhe problematikat e hasura në rastin konkret.

Për më tepër, trupit gjykues në analizë të shkakut të ankimit në raport me konkluzionet e Komisionit, nga analizimi i dokumentacionit që ndodhet në dosje, i ka rezultuar se gjyqtari Broci ka pasur një marrëdhënie juridike pasurore me shoqërinë “{***}” SHPK që në vitin 2006, kur ai ka porositur nga kjo shoqëri ndërtimin e një apartamenti banimi. Në rastin e kësaj marrëdhënieje, rezulton se gjyqtari ka pasur, përveçse marrëdhënie shoqërore me ortakët e shoqërisë, edhe një trajtim preferencial të dukshëm, duke i bërë atij zbritje prej 5140 eurosh të çmimit, për arsye të pashpjeguara.

Në kuptim të nenit 5, pika 1² e ligjit nr. 9367, i ndryshuar apo të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, kjo marrëdhënie juridike civile me karakter pasuror, përbën interes privat të zyrtarit/gjyqtarit. Përderisa rezulton ekzistenca e interesave privatë në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, atëherë shtrohet për diskutim ekzistenca e konfliktit të interesit në rastin konkret, për sa kohë që konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike. Duke pasur parasysh marrëdhënien e drejtpërdrejtë juridiko-civile me karakter pasuror, të shoqërisë me trajtim preferencial, mes zyrtarit/gjyqtarit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, e trajtuar në raport me përcaktimet e ligjit nr. 9367, i ndryshuar, trupi gjykues vlerëson se në rastin konkret zyrtari/gjyqtar ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit në këtë vendimmarrje gjyqësore, pasi edhe marrëdhënia kontraktore mes subjektit dhe palës ndërgjyqëse, shoqërisë “{***}” ShPK, nuk kishte përfunduar.

31.6. Për më tepër, në vijim të analizës së këtij shkakut ankimi, në Kolegj ka rezultuar se Komisioni gjatë hetimit administrativ, me shkresën nr. {***}, datë 23.04.2018, i ka kërkuar mendim ILDKPKI-së mbi ligjshmërinë e kryerjes së transaksioneve për pasurinë në {***}, Durrës, si dhe ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga ky transaksion. Po ashtu, Komisioni

² Neni 5, pika 1 e ligjit nr. 9367/2005: “1. Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre; b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile; c) dhuratat, premtitë, favore, trajtime preferenciale; ç) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhënesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës; d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtari që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër; dh) marrëdhënie: i) familjare apo të bashkëjetesës; ii) të komunitetit; iii) etnike; iv) fetare; v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë; e) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni.”

nëpërmjet kësaj shkrese njofton ILDKPKI-në se është vënë në dijeni për faktin që subjekti ka qenë pjesë e trupit gjykues në një rast kur ka gjykuar një çështje me palë të paditur shoqërinë “Loar” ShPK, së cilës subjekti i ka blerë apartamentin. Me shkresën nr. {***} prot., datë 07.05.2018, ILDKPKI-ja i kthen përgjigje Komisionit ku i thotë se në lidhje me marrëdhënien e krijuar midis tri subjekteve të së drejtës, z. Artan Broci, shoqërisë “{***}” ShPK dhe z. F. Gj., dhe me efektet juridike të sjella nga kontratat, për të dhënë një opinion duhet analizë e çështjes në tërësi, mbledhja e të dhënave, shpjegimeve, deklaratave nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pyetja e palëve kontraktuese, për të dhënë sqarime e shpjegime lidhur me kontratat e lidhura prej tyre dhe veprimet e kryera. Duke qenë se ky zyrtar tashmë ndodhet në procesin e rivlerësimit, pyetja e tij dhe e personave të tjerë për këtë çështje ose çështje të tjera mund të bëhet vetëm prej strukturave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Për sa i përket konfliktit të interesave, vijon në përgjigjen e saj ILDKPKI-ja, vlerësohet se në rastin konkret zyrtari/gjyqtari Artan Broci ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit në këtë vendimmarrje gjyqësore.

Nga Komisioni është pyetur subjekti në lidhje me këtë vendimmarrje, i cili ka shpjeguar: *Marrëdhënia ime me shoqërinë “{***}” është shuar 7 vjet përpara gjykimit, e kam shuar marrëdhënien që në 2007 me shoqërinë. Çështja për të cilën ju ngrini konfliktin e interesit është një çështje që e kam gjetur në Gjykatën e Lartë.*

*Çështja është regjistruar për herë të parë në Gjykatën e Lartë në vitin 2010, është pezulluar ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Apelit nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. {***}, datë 18.06.2010 të Kolegjit Civil të asaj kohe. Më pas ka kaluar në dhomë këshillimi me vendimin e datës 11.01.2013 nga Kolegji Civil i asaj kohe, mbi bazën e relacionit të përgatitur që në atë kohë, ku janë evidentuar shkeljet e ligjit (shih relacionin paraqitur si provë në komunikimin elektronik të datës 17.07.2018 dhe në seancën dëgjimore të datës 27.07.2018). Subjekti i rivlerësimit është emëruar si anëtar i Gjykatës së Lartë, me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8123, datë 26.04.2013 dhe ka filluar detyrën më datë 01.05.2013, pra pas 5 muajve që çështja kishte kaluar për gjykim. Në qoftë se ju del vendimi i 2014 që kam gjykuar unë i ndryshëm nga gjetjet që ka bërë dhoma e këshillimit në janar të 2013 pa qenë unë gjyqtar, për shkelje procedurale, unë deklaroj se largohem nga puna sot.*

Nga dokumentacioni në dosje për këtë çështje, rezulton se Komisioni i ka dërguar një shkresë me nr. {***} prot., datë 20.3.2018, Gjykatës së Lartë, ku i kërkon t’i vihet në dispozicion kopja e vendimit nr. {***} regj. themeltar/ nr. {***}. Me shkresën nr. {***} prot., datë 23.03.2018, Gjykata e Lartë i ka vënë në dispozicion Komisionit kopje të njësuara me origjinalin e vendimit nr. {***}, datë 19.06.2014.

Trupi gjykues nuk e gjen të bazuar pretendimin e subjektit në lidhje me këtë shkak ankimi, pasi edhe pse objekt material i gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, ku ka qenë anëtar subjekti, ka qenë një pasuri e ndryshme nga ajo që ka blerë nga shoqëria “{***}” ShPK në vitin 2006, siç pretendon subjekti, nuk e justifikon mosdhënien e dorëheqjes së tij nga gjykimi i kësaj çështjeje, duke pasur parasysh edhe vlerën e madhe që ka pasur padia në gjykimin e çështjes në fjalë, që rezulton në masën 391.260 euro.

Në vlerësimin e trupit gjykues, nuk është shpjegim bindës dhe i bazuar pretendimi i subjektit se marrëdhënia e tij me shoqërinë “{***}” ShPK është shuar 7 vjet përpara gjykimit të çështjes në të cilën është marrë vendimi nr. 2747 (396), datë 19.06.2014, nga Gjykata e Lartë. Kjo, pasi referuar kontratës nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 06.09.2006, të lidhur mes subjektit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, me titull “Kontratë porosie” për pasurinë në {***}, Durrës, në interpretim të kësaj kontrate dhe kushteve të saj, kuptohet se marrëdhënia e palëve në lidhje me objektin e kontratës nuk ka përfunduar me nënshkrimin e saj. Pas likuidimit të çmimit të

objektit të kontratës, përfundimit të ndërtimit dhe regjistrimit në regjistrat publikë të pronës objekt kontrate, palët kontraktore kishin detyrimin ligjor të lidhnin kontratën e shitjes së kësaj pasurie, me qëllim regjistrimin e saj në emër të blerësit, në mënyrë që ky i fundit të kishte të drejtën ta dispononte pronën ligjërisht. Rezulton e provuar se pasuria ka vazhduar të jetë e paregjistruar në regjistrat publikë edhe pas vitit 2014. Për këto arsye, trupi gjykues nuk bindet në pretendimin e subjektit se marrëdhënia e tij me shoqërinë ishte shuar, përkundrazi, përveç sa më sipër, në përgjigjet e pyetësorit në Komision, më datë 03.12.2018, subjekti ka pohuar marrëdhënien shoqërore me bashkortakun e shoqërisë “{***}” ShPK. Fakti që marrëdhënia e subjektit me shoqërinë nuk ishte konkluduar me kontratën përfundimtare të shitjes së pasurisë në {***}, Durrës edhe gjatë vitit 2014, kohë kur subjekti ka gjykuar çështjen ku ka qenë palë ndërgjyqëse edhe shoqëria “{***}” ShPK, bindi trupin gjykues se kjo marrëdhënie ka vazhduar edhe në kohën kur është gjykuar çështja me nr. {***} vendimi të datës 19.06.2014.

Në konkluzion të analizës së këtij shkak ankimi, si dhe bazuar në jurisprudencën e Kolegjit në vendimin nr. 10/2019³, nga trupi gjykues arrihet në përfundimin se subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit kur ka gjykuar edhe këtë çështje si anëtar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit në lidhje me këtë fakt, por për të qenë sa më i qartë në arsyetimin e tij në rastin konkret, Komisioni duhet t’i referojë parimeve të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, jurisprudencës së GjEDNj, bazës ligjore në legjislacionin tonë të brendshëm, Kodit të Procedurës Civile, për të përforcuar konkluzionet mbi gjendjet faktike dhe ligjore të situatave të konfliktit të interesave.

31.7. Në lidhje me pretendimin e subjektit, që e citon brenda shkaqeve të ankimit për pasurinë shtëpi në plazh, Durrës, se nga Komisioni nuk interpretohet ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, trupi gjykues, në analizën e këtij shkak ankimi, ka parasysh parashikimet ligjore të neni 11 i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar, ku parashikohet tatimi për kalimin e të drejtës së pronësisë dhe se ky tatim paguhet nga shitësi para kryerjes së regjistrimit të pasurisë. Pra, pasuria nuk regjistrohet pa paguar tatimin në ZVRPP, e cila është e detyruar që brenda datës 20 të çdo muaji të transferojë për llogari të administratës tatimore tatimin e paguar. Konstatohet se ligji i mësipërm përcakton detyrime për pasuritë e regjistruara pranë ZVRPP-ve dhe për kontrata shitblerjeje të të drejtave reale të pasurive të regjistruara rregullisht në regjistrat publikë, duke përcaktuar si agjent tatimor për vjeljen e taksave dhe tatimeve ZVRPP-të përkatëse. Në vitin 2010 pasuria, apartament në {***}, nuk ishte e regjistruar në regjistrat publikë të ZVRPP Durrës dhe për këtë shkak nuk mund të paguhej tatimi nga subjekti te kjo zyrë. Ligji parashikon agjent tatimor për mbledhjen dhe transferimin në buxhetin e shtetit të tatimeve dhe taksave, ZVRPP-të për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme dhe të drejtave reale nëpërmjet veprimeve juridike që parashikohen në dispozitat e Kodit Civil.

Për trupin gjykues, me interes në këtë proces është ligjshmëria e të ardhurave të përfituara nga “shitja”⁴ e këtij apartamenti, shtëpi në plazh, Durrës. Në këtë këndvështrim, Kolegji vlerësoi të gjitha rrethanat që kanë rezultuar nga hetimi administrativ i çështjes, dhe që përcaktojnë qëndrimin e Kolegjit në lidhje me këtë çështje. Siç është pranuar në paragrafët e mësipërm, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë mundësinë për të blerë me burime të ligjshme këtë

³ Vendimi i Kolegjit të Posaçëm nr. 10/2019.

⁴ Subjekti në pikën 107 të ankimit e citon shitje e të drejtës reale të apartamentit kontratën me titull “Kontratë prenotimi dhe dorëzimi apartamenti”, e datës 15 prill 2010, lidhur mes palëve, siç janë cilësuar në kontratë: I porosituri – Artan Broci dhe porositës – F. Gj.

pasuri, duke qenë se nga analiza financiare rezultoi me balancë negative në momentin e blerjes së saj. Gjithashtu, Kolegji konstatoi se subjekti ka kryer deklarime të rreme në lidhje me çmimin e blerjes së kësaj pasurie, duke deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* një çmim të ndryshëm nga ai që ai përshkruan gjatë shpjegimeve në procesin administrativ. Përpos këtyre fakteve, Kolegji konstatoi se edhe vetë pagimi i vlerës së çmimit nga subjekti i rivlerësimit të shoqëria “{***}” ShPK ishte një rrethanë që mbeti e paprovuar, për shkak të paqartësive e defekteve në mandatarkëtimet e datave 05.09.2006, 03.03.2007 e 30.09.2007, që ka paraqitur subjekti. Të gjithë këtij transaksioni me elemente të paprovuara e të dyshimta, i bashkëngjitet transaksioni me këtë pasuri që lidhet me kalimin e të drejtave të fituara prej subjektit të rivlerësimit nga shoqëria “{***}” ShPK te shtetasi F. Gj., nëpërmjet një kontratë prenotimi/porosie e lidhur në të njëjtën, datë 15.04.2010, dhe për të njëjtin objekt, për të cilin shoqëria “{***}” ShPK lidh po ashtu një kontratë porosie po me shtetasin F. Gj.. Përveç pashpjegueshmërisë së ekzistencës së këtyre dy kontratave të lidhura mes të njëjtave palë dhe për të njëjtin objekt, Kolegji konstatoi gjithashtu se vlera e shitjes së këtyre të drejtave nga subjekti i rivlerësimit te shtetasi F. Gj. është rritur ndjeshëm (nga 51.000 në 102.000 euro) vetëm në një periudhë katërvjeçare, pavarësisht marrëdhënieve të mira shoqërore që subjekti ka pretenduar se ka me këtë shtetas. Në vijim, subjekti dështoi të provonte se shtetasi F. Gj. i ka paguar atij vlerën prej 102.000 eurosh, për sa kohë që nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ligjor provues për këtë fakt, për më tepër që po në të njëjtën datë rezultoi se shtetasi F. Gj. ka paguar shumën prej 82.000 eurosh te shoqëria “{***}” ShPK, referuar mandatpagesës së datës 15.04.2010 dhe shumën prej 20.000 eurosh, referuar mandatpagesës së datës 20.12.2010. I gjithë ky transaksion është finalizuar me shitjen e kësaj pasurie nga shoqëria “{***}” ShPK te shtetasi F. Gj. nëpërmjet kontratës së shitjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 02.12.2016, duke shmangur pagimin e tatimit për kalimin e pronësisë dhe duke përfituar nga fakti që pasuria ndodhej e regjistruar në emër të shoqërisë në regjistrat e ZVRPP-së. Të gjitha veprimet e mësipërme analizohen e vlerësohen nga Kolegji edhe në këndvështrim të situatës së pranuar të konfliktit të interesit ndërmjet subjektit e shoqërisë “{***}” ShPK.

Duke konsideruar të gjitha këto veprime juridike që në fillimin e tyre, të afektuara me mungesë të burimeve të ligjshme, me mosprovim të pagimit të çmimit të blerjes së apartamentit, me deklarime të rreme për vlerën e këtij çmimi, e më pas me mosprovimin e përfitimit të çmimit të shitjes, me kryerjen e veprimeve juridike të pashpjegueshme në një kontekst logjik e ligjor të qarkullimit civil të sendeve, me veprime që kanë pasur për qëllim shmangien nga pagimi i detyrimeve tatimore, të realizuara me bashkëpunimin e një shoqërie me të cilën subjekti gjendej në kushtet e konfliktit të interesit, e çojnë Kolegjin në konkluzionin se subjekti nuk arriti të provojë se shumën e parave prej 102.000 eurosh, të përfituara në finalizimin e këtij transaksioni e të investuara në bonot e thesarit, ishte krijuar me burime të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

31.8. Brenda shkaqeve të ankimit për pasurinë apartament në {***}, Durrës, subjekti pretendon edhe mungesë objektiviteti dhe arsyetimi nga Komisioni për afatin ligjor të ruajtjes së dokumenteve tatimore, mosaplikimin e kërkesave të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, moskalimin e barrës së provës, mospërfshirjen në vlerësimin e Komisionit të provave të paraqitura nga subjekti.

Në përgjigje të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues, siç ka arsyetuar në paragrafin 31.1 të këtij vendimi, edhe duke konsideruar si të paguara tatimet për të ardhurat nga qiratë, rezultoi se përsëri subjekti në vitin 2006 ndodhej në kushtet e një balance negative prej minimalisht 229.502,36 lekësh.

Analizimi nga trupi gjykues i shkaqeve të ankimit në lidhje me pasurinë zyrë, me sipërfaqe 40 m² + 11,5 m², me adresë bulevardi “{*}”, Tiranë**

32. Në lidhje me shkakun e ankimit të trajtuar në paragrafin 11 të këtij vendimi, në të cilin subjekti ankon konkluzionin e Komisionit se ka ngelur e paprovuar mënyra se si është kryer pagesa e kësaj kontrate, e kalimit të pronësisë së pasurisë zyrë me sipërfaqe 40 m² + 11,5 m² më datë 28.02.2003, pasi rezulton se të gjitha tërheqjet nga banka janë kryer më datë 26.06.2003 dhe, për pasojë, subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për ta blerë këtë pronë në datën 28.02.2003, të deklaruar në kontratë, më datë 20.02.2018 subjekti është pyetur në mënyrë elektronike nga Komisioni: *Ju keni blerë një pasuri, ambient zyre me sipërfaqe 40 + 11 m² në bulevardin “{***}”, zona kadastrale {***}, nr. {***} pasurie, me kontratën e shitblerjes së datës 28.02.2003. Çmimi i shitjes ka qenë 45.000 USD, deklarohet se shitësit e kanë marrë gjithë këtë shumë jashtë kësaj zyre. Referuar kontratës së kredisë bankare, datë 24.06.2003, në American Bank of Albania, për shumën 24.000 USD me qëllim financimin e blerjes së zyrës në bulevardin “{***}”, a mund të na thoni kur është shlyer vlera prej 45.000 USD për blerjen e kësaj pasurie? A keni pasur të ardhura për likuidimin e saj, referuar kushteve të kontratës?*

Subjekti në kthimin e përgjigjes elektronike të datës. 26.02.2018, ka deklaruar se një pjesë të likuiditeteve e ka disponuar nga kursimet ndër vite dhe pjesa tjetër është marrë borxh pranë të afërmeve në Shkodër, vlerë e cila më pas është likuiduar me marrjen e kredisë. Këtë deklaramin subjekti rezulton se nuk e ka bërë as në deklaratën periodike, as në atë *vetting*.

Në vlerësimin e trupit gjykues, edhe pse subjekti pretendon që nuk i është kaluar barra e provës për mënyrën e pagesës së vlerës 24.000 USD, dhe konstatohet se me rezultatet e hetimit administrativ Komisioni i ka kaluar barrën e provës vetëm për vlerën 21.000 USD, përfundim i cili pasqyrohet edhe në arsyetimin e vendimit të Komisionit në paragrafin 155, subjekti duhej të ishte shterues me deklaratimet dhe shpjegimet e tij, si dhe me dokumentet që mbështesin këto deklarime/shpjegime. Në fakt, për trupin gjykues, subjekti për të arritur nivelin e besueshmërisë në vlerësimin e pasurisë, që në fillim të procesit të rivlerësimit në deklaratën *vetting* duhej të deklaronte, shpjegonte dhe provonte mjaftueshëm në lidhje me tërë vlerën e pasurisë, 45.000 dollarë amerikanë, që përfshin dy vlerat objekt hetimi, 21.000 USD plus 24.000 USD. Kjo pasi, në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, që parashikon se objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij, subjektet e rivlerësimit duhet të rezultojnë shterues në Komision me deklaratimet e tyre, sidomos në deklaratën *vetting*.

Për më tepër, nga hetimi i kryer nga Komisioni në lidhje me këtë pasuri, zyrë, në bulevardin “{***}”, Tiranë, rezulton se nuk përputhen deklarimi te noteri më datë 28.02.2003 për shlyerjen plotësisht të të gjithë shumës menjëherë, me deklarimin e subjektit në deklaratën *vetting* për burimin e të ardhurave për blerjen e kësaj zyre. Referuar të dhënëve nga Intesa Sanpaolo Bank, me shkresën nr. {***} prot., datë 15.02.2018, rezulton se kredia është disbursuar afro 4 muaj pas likuidimit të vlerës për blerjen e zyrës. Shuma e tërhequr nga banka *cash* është më e vonë se data e blerjes së kësaj prone nga subjekti i rivlerësimit dhe nuk është i provuar destinacioni i kësaj kredie. Nga analiza ekonomike e të ardhurave të subjektit dhe të familjarëve të tij, rezultoi se ai nuk ka pasur aftësi pagese të vlerës prej 45.000 USD më datë 28.02.2003, kur është bërë likuidimi i vlerës për blerjen e kësaj zyre.

Në konkluzion të analizës në Kolegj, mbi bazën e shkaqeve të ankimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës në dosje, në lidhje me pasurinë zyrë 40 m² + 11,5 m², me adresë bulevardi “{***}”, Tiranë, trupit gjykues i rezulton se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme

për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie. Në këto kushte, situata faktike klasifikohet sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

Analizimi nga trupi gjykues i shkaqeve të ankimit në lidhje me të ardhurat nga qiraja e shtëpisë në Shkodër

33. Në shkakun e ankimit të trajtuar në paragrafin 12 të këtij vendimi, në të cilin subjekti shprehet: [...] *Komisioni në vendimin nr. 53, datë 31.07.2018, ka ngritur pretendimin në pikën 217 të tij se nuk u provua ligjshmëria e të ardhurave të përfituara nga qiraja e shtëpisë në Shkodër, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Marrëdhënia e qirasë është deklaruar që në vitin 2004 e në vazhdim si pranë ILDKPKI-së, ashtu dhe në deklaratën vetting. [...],* rezulton se sipas prokurës së datës 25.5.1999, ai i ka dhënë të drejtën nënës së tij ta përfaqësojë në marrëdhëniet me të tretët për dhënien me qira të shtëpisë së banimit në qytetin e Shkodrës. Për këtë pasuri, subjekti shpjegon se pagesat e tatimit mbi qiranë janë paguar nga nëna e tij. Nëna e tij i është drejtuar me shkresë Postës Shqiptare, filiali Shkodër, që të konfirmonte pagesat e bëra nga viti 2004-2011. Filiali i Postës Shqiptare Shkodër, me shkresën kthim përgjigjeje nr. {***} prot., datë 12.07.2018, i bën me dije kërkueses se afati i ruajtjes së dokumentacionit është 5 vjet dhe dokumentacioni për periudhën e kërkuar nuk është më në ruajtje në arkivin e postës. Po ashtu, Komisioni i është drejtuar zyrës së tatimeve Shkodër për të kërkuar informacion për tatimpaguesen H. B., nëse ajo ka paguar tatimin e qirasë. Me shkresën nr. {***} prot., datë 20.03.2018, Drejtoria e Tatimeve Shkodër kthen përgjigjen se znj. H. B. nuk është e regjistruar pranë kësaj drejtorie për ushtrim aktiviteti privat.

Në dosje ndodhet një kontratë qiraje e thjeshtë, e lidhur më datë 20.11.2007 nga nëna e subjektit me të ndjerin, z. N. B., dhe një deklaratë noteriale e z. J. B., e datës 11.07.2018, nr. {***} rep., nr. {***}, kol., që është djali i të ndjerit N. B. që konfirmon marrëdhënien e qirasë nga viti 2007 deri në vitin 2011. Në dosje ndodhen gjithashtu disa polica sigurimi të lëshuara nga shoqëritë e sigurimit, që vërtetojnë se banesa është siguruar nga zjarri.

Trupi gjykues, në përputhje me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet: *Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj – vlerëson faktin se subjekti në lidhje me të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e pasurisë në Shkodër, nuk justifikon bindshëm burimin e ligjshëm të tyre. Ndërkohë që rezulton se në deklaratat periodike, të ardhurat nga qiraja në Shkodër subjekti i ka deklaruar nga 2004 e në vazhdim, në deklaratën vetting rezulton deklarimi i tyre që nga viti 2000 e në vazhdim. I paprovuar mbetet edhe fakti i marrëdhënies së qirasë për këtë pasuri, përderisa nuk ka asnjë dokumentacion që e provon ekzistencën dhe pagimin e qirasë. Për pasojë, përveç kësaj pasaktësie në deklarime, mbetet plotësisht i paprovuar fakti i pagimit të detyrimeve tatimore për këto të ardhura nga qiraja, sipas kërkesave të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.*

34. Në lidhje me shkakun e ankimit të trajtuar në paragrafin 13 të këtij vendimi, në të cilin subjekti kundërshton qëndrimin e Komisionit, të mbajtur në paragrafin 224 të vendimit, lidhur me investimin në ambientin të “{***}”, për të cilin subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se përmirësimet e sendit janë kryer nga vetë qiramarrësit, duke paraqitur si provë edhe një deklaratë me nr. {***} prot., datë 2.07.2018, të lëshuar nga shoqëria “{***}” (qiramarrësi), e cila është administruar në dosje, në vlerësimin e trupit gjykues ky shkak ankimi nuk duket relevant apo i lidhur ngushtë me ndonjë konkluzion të Komisionit dhe i përshtatshëm me objektin e gjykimit dhe, për pasojë, nuk mund të merret në konsideratë në shqyrtimin e

vendimit objekt shqyrtimi. Faktet e cituara nga subjekti në këtë shkak ankimi nuk janë ngritur nga Komisioni në nivelin e dhënies së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

Analizimi nga trupi gjykues i shkakut të ankimit në lidhje me pasurinë e vlerësuar nga Komisioni si pasuri e padeklaruar, e mbajtur nga persona të tjerë

35. Në lidhje me shkaqet e ankimit të trajtuara në paragrafin 14 të këtij vendimi, në të cilat subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit, se ai ka mbajtur pasuri të padeklaruar të fshehur, mbështetur në një hetim të njëanshëm, tendencioz, të pathelluar, pa i dhënë subjektit mundësi të shpjegohet për gjatë procesit të hetimit administrativ, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit në paragrafin 258, pika VII të vendimit se subjekti ka pasuri të fshehtë të padeklaruar, e cila mbahet nga persona të tretë, e trajtuar në paragrafët 248-257 të vendimit, është i gabuar dhe nuk rezulton të jetë bindës e rezultat i një hetimi administrativ të thelluar dhe, për më tepër, të kërkuar prej subjektit për të arritur në bindjen, siç shprehet Komisioni, se *[..] subjekti ka pasuri të fshehtë të padeklaruar, e cila mbahet nga persona të tretë.*

Subjekti nëpërmjet ankimit ka kërkuar të dëgjohet dhe të paraqesë prova të reja për këtë fakt. Trupi gjykues, siç është arsyetuar edhe në paragrafët e mësipërm të këtij vendimi, në përputhje me nenin 49, pika 6, germa “d” e ligjit nr. 84/2016, vendosi që provat e reja të refuzohen, me arsyetimin që edhe po të konsiderohet i vërtetë fakti që pretendon subjekti sipas këtij shkak ankimi, nuk ndikon në marrjen e vendimit.

Trupi gjykues çmon se shkakun e ankimit të subjektit në lidhje me këtë pasuri, është i drejtë e qëndron nga njëra anë dhe nga ana tjetër konstatohet se konkluzioni i Komisionit në paragrafin 258, pika VII e vendimit të tij për këtë fakt nuk është i drejtë dhe i bazuar në prova që krijojnë bindje se subjekti ka fshehur pasurinë e tij.

Përveç pretendimit për hetim të njëanshëm dhe tendencioz në Komision, trupi gjykues e gjen të drejtë këtë shkak ankimi të subjektit, pasi rezulton se nga Komisioni nuk është bërë një hetim i thelluar dhe i plotë për të arritur në një konkluzion të drejtë dhe të bazuar në prova.

36. Në lidhje me shkakun e ankimit të trajtuar në paragrafin 15 të këtij vendimi, në të cilin subjekti ankohet për një gjetje të Komisionit, sipas së cilës Artan Broci është propozuar në vitin 2004 nga KLD-ja për në Gjykatën e Krimeve të Rënda, gjetje e cila është jashtë afatit kushtetues dhe gjatë hetimit administrativ ai nuk është njohur për këtë kërkim të Komisionit duke u përballur me “efektin surprizë”, trupi gjykues vlerëson se ky shkak ankimi nuk është relevant ose i lidhur ngushtë me asnjë konkluzion të Komisionit, apo i përshtatshëm me çështjen që gjykohet, apo të merret në konsideratë në shqyrtimin e vendimit objekt shqyrtimi.

Në vlerësimin tërësor të Komisionit, në pjesën IV të arsyetimit të vendimit, kriteri i kontrollit të figurës nuk është ngritur në nivelin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit. Trupi gjykues, për t’i dhënë një përgjigje edhe këtij shkak ankimi, pasi shqyrtoi shkaqet e tjera të ankimit të subjektit, arriti në konkluzionin se ai nuk gjendet i mjaftueshëm për të ndryshuar vendimin e Komisionit.

37. Në shkakun e ankimit për kriterin e kontrollit të aftësive profesionale, subjekti shprehet se vendimi i Komisionit është kontradiktor, në shkëlqje flagrante të ligjit dhe të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe përmban “efektin surprizë”, pasi nga njëra anë subjekti propozohet “i aftë” nga relatorja dhe më pas shkarkohet për shkak të “denoncimeve të ardhura nga publiku”, një vendimi të Gjykatës Kushtetuese nr. 46, datë 19.07.2016, si dhe konfliktit të interesit të paktën në një rast.

Subjekti kundërshton administrimin nga Komisioni të dy raporteve shtesë nga IKLD-ja dhe të 6 ankesave për te cilat nuk rezulton që ai të jetë njohur me to gjatë procesit administrativ.

Arsyetimi i vendimit për subjektin është diskriminues dhe dualist në raport me subjektet e tjera të rivlerësimit, sa i përket trajtimit të rezultateve që dalin nga kontrolli i kriterit të aftësive profesionale.

Komisioni, në mënyrë subjektive, ka përzgjedhur tri denoncime për të cilat ka marrë vlerësimin nga IKLD-ja dhe i ka bërë pjesë të arsyetimit të vendimit, megjithëse ato nuk përfshihen në burimet e vlerësimit profesional.

Subjekti kundërshton mënyrën se si Komisioni ka analizuar denoncimet e publikut dhe konkluzionet që ka arritur për këto denoncime.

Trupi gjykues konstaton se në paragrafin 270 të arsyetimit të vendimit të tij, Komisioni shprehet se vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit është bazuar në: (i) të dhënat e paraqitura në raportin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, dhe (ii) pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Kreu II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për sa më sipër, relatori i çështjes propozoi për subjektin e rivlerësimit z. Artan Broci, “i aftë”.

Në vlerësimin e trupit gjykues, me të drejtë Komisioni, vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 46, datë 19.07.2016, denoncimet e publikut, si dhe gjendjet e konfliktit të interesit për subjektin në rastet e konstatuara i) në vendimin nr. {***}, datë 19.06.2014, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ii) në vendimin nr. {***}, me nr. {***} regjistri themeltar, më datë 22.05.2014, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si dhe iii) në vendimin nr. {***}, datë 16.07.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke pasur parasysh kërkesat e pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet: [...] *Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave*, i ka arsyetuar në kreun IV, paragrafi 297, germa “b” e vendimit vlerësimin tërësor të çështjes. Situatë faktike kjo, e cila analizohet dhe ngrihet në nivelin e kërkesave të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet: *Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit, parashikohet të shkojë në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit*. Prandaj pretendimi i subjektit në ankim në lidhje me mënyrën se si Komisioni ka analizuar denoncimet, nuk është i bazuar.

Gabimet e konstatuara nga gjetjet tek analizimi i këtyre denoncimeve, me të drejtë Komisioni i ka vlerësuar në raport me kërkesat e nenit neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pa i përfshirë në vlerësimin e aftësive profesionale.

Trupi gjykues vlerëson se nuk qëndron pretendimi i subjektit për “efektin surprizë”, pasi aplikimi i nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe i kërkesave të tij nuk varet vetëm te vlerësimi i aftësive profesionale.

Në vlerësimin tërësor të Komisionit, në pjesën IV të arsyetimit të vendimit, kriteri i kontrollit të aftësive profesionale nuk është ngritur nga Komisioni në nivelin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit. Për pasojë, nuk qëndron pretendimi i subjektit se nga Komisioni është shkelur neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke mos iu garantuar e drejta e mbrojtjes efektive. Në vlerësimin e tërësisë së çështjes nga trupi gjykues, ka rezultuar se subjektit, ndryshe nga sa pretendon në ankim, i është garantuar e drejta e

mbrojtjes efektive. Ankimi i subjektit në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, për trupin gjykues, nuk rezulton relevant ose i lidhur ngushtë apo i përshtatshëm me thelbin e çështjes, apo të merret në konsideratë në shqyrtimin e vendimit objekt shqyrtimi, pasi nuk ndikon dhe nuk e cenon vendimin.

Në lidhje pretendimin e subjektit, në vijim të shkaqeve të ankimit për kriterin e kontrollit të aftësive profesionale, për cenimin e hapur nga Komisioni të nenit 8 të KEDNj-së, trupi gjykues vlerëson se Aneksi i Kushtetutës në nenin A të tij ka parashikuar kufizime të drejtave kushtetuese dhe saktësisht në paragrafin e parë: *Me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve që lidhen me të drejtën për respektimin e jetës private, si dhe nenet 36 dhe 37, dispozitat që lidhen me barrën e provës, nenet 128, 131, nënparagrafi “f”, 135, 138, 140, 145, paragrafi 1, 147/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, 149/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, kufizohen pjesërisht, sipas nenit 17 të Kushtetutës.* Nga ana tjetër, neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se kufizime të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të tjerëve.

Gjithashtu, duke iu referuar ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9887”), në nenin 4, pika 4, germa “b” e tij, parashikohet se ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave vetëm për rastet kur jepet informacion për persona publikë, zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre.

Pra, përpunimi i të dhënave personale dhe mbrojtja e tyre gjen kufizim nga Kushtetuta, Aneksi i Kushtetutës dhe në raste të caktuara edhe nga vetë ligji nr. 9887, duke i parashikuar si raste përjashtimore të mbrojtjes së të dhënave personale për subjektet e rivlerësimit.

Shkaqet e ankimit të subjektit në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale konstatohen nga trupi gjykues në tërësinë e tyre jo relevante ose të lidhura ngushtë apo të përshtatshme me thelbin e çështjes, që të merren në konsideratë në shqyrtimin e vendimit objekt shqyrtimi, pasi nuk ndikojnë në cenimin e vendimit. Të gjitha këto shkaqe ankimi kanë lidhje me kriterin e kontrollit të aftësive profesionale, që nuk është ngritur nga Komisioni në nivelin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit. Numrin relativisht të madh të denoncimeve për subjektin dhe konstatimet e shumta negative për të në vlerësimin e këtyre denoncimeve, Komisioni nuk i ka konsideruar në vlerësimin e aftësive profesionale, por me të drejtë në vlerësimin tërësor të tij, në pjesën IV, germa “b” e arsytimit të vendimit, i ka ngritur dhe i ka arsyetuar në nivelin e parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

38. Në shkakun e ankimit të trajtuar në paragrafin 16 të këtij vendimi, subjekti shprehet se kundërshton qëndrimin e Komisionit në raport me analizën që i bëhet vendimit nr. 46, datë 19.07.2016, të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me situatën e konfliktit të interesit.

Subjekti në lidhje me këtë shkak ankimor pretendon se në thelb të arsytimit të atij vendimi (nr. 46, datë 19.07.2016) i Gjykatës Kushtetuese është fakti se *pjesëmarrja e gjyqtarit Artan Broci në dhënien e vendimit nr. {***}, datë 24.01.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe në dhënien e vendimit nr. {***}, datë 16.07.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), nuk ka garantuar respektimin e parimit të paanësisë dhe ka krijuar dyshime në këndvështrimin e testit objektiv të këtij parimi. [..]. Çështja në Gjykatën e Lartë ka ardhur mbi rekursin e z. Ç. dhe është regjistruar më datë 22 prill të vitit 2015, ku sipas sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve rezulton se subjekti është caktuar si relator i kësaj çështjeje. Për afro 3 muaj që unë isha caktuar si relator i kësaj çështjeje, rekursuesi, z. V. Ç.,*

nuk e ka ngritur ndonjëherë përpara Gjykatës së Lartë pretendimin për testin objektiv dhe parimin e paanësisë. Ai është ngritur për herë të parë vetëm përpara Gjykatës Kushtetuese. Për shkak të kohës së gjatë të kaluar, mbi 7 vite, dhe numrit të madh të çështjeve që unë kam gjykuar, është e pamundur të mbahet mend nga ana ime një çështje e gjykuar në vitin 2008 me njërën prej palëve, pa u ngritur si pretendim më parë.

Në vlerësimin e trupit gjykues, referuar këtij shkak ankimi, edhe përse nuk rezulton në dosje e administruar nga Komisioni kërkesa e bërë nga kërkuesi/denoncuesi V. Ç. para Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, në lidhje me përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi i kësaj çështjeje, mosbërja me dije e këtij fakti subjektivit prej ankuesit V. Ç. gjatë kohës që subjekti kishte për gjykim çështjen e tij, por ngritja e një pretendimi të tillë vetëm përpara Gjykatës Kushtetuese, nuk e justifikon mosheqjen dorë të subjektivit nga vendimmarrja e kësaj çështjeje për të garantuar parimin e paanësisë. Konflikti i interesit në rastin konkret qëndron edhe në faktin se në kundërshtim me kërkesat e nenit 72, pika 4⁵ e Kodit të Procedurës Civile, subjekti ka marrë pjesë në gjykimin e një çështjeje të gjykuar më parë nga ai. Edhe në analizë të këtij shkak ankimi, nga trupi gjykues vlerësohet se nuk qëndron pretendimi i subjektivit se nga Komisioni është shkelur neni 6 i KEDNj-së. Në vlerësimin e tërësisë së çështjes, ka rezultuar se subjekti i është garantuar procesi i rregullt ligjor sipas standardeve të nenit 6 të KEDNj-së.

Sa më sipër, ky shkak ankimi nuk qëndron dhe, për më tepër, nga trupi gjykues vlerësohet se edhe në rastin e gjykimit të kësaj çështjeje, subjekti ka qenë në situatën e shkeljes së ligjit.

Në përfundim të analizës së tij, trupi gjykues, nga shqyrtimi tërësor i çështjes mbi bazën e ankimit të subjektivit, mbështetur në legjislacionin e zbatueshëm, arrin në përfundimin se vendimi i Komisionit nr. 53, datë 31.07.2018, është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi, pasi rezultoi se, përveç shkakut të ankimit në lidhje me pasurinë e vlerësuar nga Komisioni si pasuri e padeklaruar dhe e mbajtur nga persona të tjerë, asnjë shkak tjetër ankimi i subjektivit nuk qëndron plotësisht apo në atë masë sa ta bëjë të cenueshëm apo të gjendet i mjaftueshëm për të ndryshuar vendimin objekt shqyrtimi.

VI. Konkluzionet e trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Trupi gjykues, pasi u njoh me të gjitha aktet e ardhura dhe të administruara nga Komisioni, e shqyrtoi vendimin e Komisionit nr. 53, datë 31.07.2018, mbi bazën e shkaqeve të ankimit të subjektivit të rivlerësimit, në dhomë këshillimi, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenet 47, 48 pika 1, 49, 55 të ligjit nr. 49/2012 dhe arriti në konkluzionin se:

- I. Lidhur me pasurinë, shtëpi plazhi, apartament 147 m² në {***}, Durrës, blerë në vitin 2006 dhe shitur në vitin 2010, referuar situatës financiare të subjektivit për vitin 2006, rezulton se ai nuk arrin të justifikojë me të ardhura të ligjshme blerjen e kësaj pasurie, si edhe shpenzimet dhe kursimet e krijuara në këtë vit. Në këto kushte, situata faktike klasifikohet sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
- II. Në deklaratën *vetting* subjekti për këtë pasuri ka bërë deklaram të rremë, lidhur me vlerën reale të blerjes së kësaj pasurie. Në këto kushte, situata faktike klasifikohet sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.

⁵ Neni 72, “Rastet për përjashtimin e gjyqtarit”: “Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur: [...] 4. ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njërës apo tjetrës palë.

- III. Në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga shitja e këtij apartamenti, subjekti nuk arriti të provojë ligjshmërinë e krijimit të këtyre të ardhurave, si dhe të pasurive të krijuara prej tyre. Në këto kushte, situata faktike klasifikohet sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
- IV. Në lidhje me pasurinë zyrë 40 m² + 11,5 m², me adresë bulevardi “{***}”, Tiranë, rezultoi se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie. Në këto kushte, situata faktike klasifikohet sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
- V. Në lidhje me situatat e konfliktit të interesit, të trajtuara në vendimin e Komisionit, rezultoi se subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit në lidhje me vendimmarrjet e tij: i) në vendimin nr. {***}, datë 19.06.2014, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; ii) në vendimin nr. {***}, me nr. {***} regjistri themeltar, datë 22.05.2014, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si dhe iii) në vendimin nr. {***}, datë 16.07.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Trupi gjykues të Kolegjit, nga vlerësimi tërësor, i rezultoi se subjekti me veprimet dhe mosveprimet e tij ka cenuar besimin e publikut tek institucionet e sistemit të drejtësisë, duke i bërë kështu të aplikueshme kërkesat e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
- VI. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shkaqet e tjera të ankimit të subjektit, arriti në konkluzionin se ato nuk gjenden të mjaftueshme për të ndryshuar vendimin e Komisionit.
- VII. Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në konkluzionet e mësipërme, në mbështetje të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, çmon se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 53, datë 31.07.2018, është i drejtë, i bazuar në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 53, datë 31.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Artan Broci.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
3. U shpall në Tiranë, sot, më datë 18.07.2019.

ANËTAR

Luan Daci

nënshkrimi

RELATOR

Ardian Hajdari

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol Çomo

nënshkrimi

ANËTARE

Albana Shtylla

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina Rama

nënshkrimi